



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

## RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

### **Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional**

**“Për programin e studimit Master Profesional  
“Multimedia dhe Televizion Dixhital” me profile:**

- a) Produksion dhe Post-Produksion
- b) Animim 3D
- c) Përpunimi imazhi

**i**

**Institucionit të Arsimit të Lartë “UNIVERSITETI  
ALEKSANDËR MOISIU DURRËS”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Dr. Arben Muka

2. Dr. Diana KALAJA

Shkurt 2020

## PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM TE PROGRAMIT

Programi i studimit Master Profesional “Multimedia dhe Televizioni Dixhital”, si strukturë e Departamentit të Teknologjisë së Informacionit në Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit në Universitetin “Aleksandër Moisiu” në Durrës, UAMD, ka nisur të zbatohet në vitin akademik 2018 -2019.

Programi synon që përmes një kurrikule një vjeçare, të përmbushë nevojat dhe preferencat për specialistë në multimedia, në tri drejtime: Produksion dhe Postproduksion; Animim 3D dhe Përpunim Imazhi.

Pas përfundimit të programit, të diplomuarit kanë mundësi të përshtaten dhe të kontribuojnë në tregun e punës, të realizojnë produkte dhe shërbime në redaksitë audio dhe audiovizive, në njësi të PR-it, të bëhen pjesë ose të menaxhojnë fushata promovuese, informuese e ndërgjegjësuese, si dhe në sektorë të ndryshëm të medias dhe komunikimit.

Hapja e këtij programi të ciklit të dytë me kohë të plotë të studimeve bazohet në Urdhrin nr. 705, të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, datë 19.10.2018, ka 60 kredite ECTS dhe zgjat 1 vit akademik.

Programi është aktivizuar si përfshirje në projektin “Development and Implementation of Multimedia and Digital TV Curricula (DIMTV)” Erasmus +, si dhe është mbështetur e mbështetet nga kooperimi me partnerët evropianë, universitetet e Lubjanës, Tartu dhe Ostrava.



2  


## Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm i programit të studimit “Master Profesional “Multimedia dhe Televizion Dixhital” në UAMD filloi punën për vlerësimin duke u njohur fillimisht me materialet dokumentare të vendosur në site e ASCAL. Nga koordinatori i programit janë hedhur dokumentet e nevojshme thuajse për të gjitha pikat që vlerësohen në program.

Në etapën e dytë, duke u koordinuar edhe nga ekspertja e ngarkuar nga ASCAL, u planifikua vizita në institucion në datat 20-21 nëntor 2019. Gjatë vizitës u realizuan takimet me Rektoren e Universitetit Prof. Dr. Kseanela Sotirofski, me dekanen e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit, Prof. As. Lindita Mukli, me koordinatoren e programit mësimor nën vlerësim njëkohësisht edhe Dr. Luciana Toti, si edhe me stafin akademik, administrativ dhe studentët që përfunduar programin në vitin mësimor 2018-2019. Vizita dhe takimet sollën informacion shtesë për vlerësimin e këtij programi studimi. Një informacion mjaft i vlefshëm i marrë gjatë vizitës ishte diskutimi me studentët dhe asistimi në punët që ata përgatisnin në studiot e multimedias dhe të kompjuterëve. Studio e multimedias është pajisur me pajisjet dhe software e nevojshme falë bashkëpunimit dhe financimit në kuadër të projektit BE “*Development and Implementation of Multimedia and Digital TV Curricula (DIMTV)*” program “Erasmus +” edhe në bashkëpunim me tre universitete të huaja që kanë asistuar në hartimin e kurikulave mësimore. Gjatë vizitës u kërkua informacion shtesë i cili u plotësua dhe u vendos në faqen e ASCAL.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm gjeti një bashkëpunim shumë produktiv gjatë vizitës në institucion.

Më datë 21.01.2020, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 4/6 Prot., datë 23.01.2020, dërgohet në Institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. Më datë 25.01.2020 31.01.2020, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 153/1 Prot., datë 30.01.2020, Institucioni përcjell përgjigjen mbi Draft-Raportin, përmes së cilës shpreh dakordësinë me përmbajtjen e tij. Sa më lart, Draft-Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

**Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional  
“Multimedia dhe Televizion Dixhital” me profile: a) Produksion dhe Post-  
Produksion; b) Animim 3D; c) Përpunimi imazhi”**

**I. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT**

<b>Standardi I.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi të ciklit të dytë “Master profesional” në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	<p>Programet e Master Profesional të ofruar nga Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës janë ndërtuar duke u bazuar në Statutin e tij, Planin e Zhvillimit Strategjik, 2016-2020, si edhe Planin e Zhvillimit Strategjik të MTVD 2018-2022. Këto dokumente janë miratuar me vendim të Senatit të UAMD.</p> <p>Statuti, miratuar me Vendimin e Senatit nr. 11 datë 31.03.2017, është mbështetur në Kushtetutën e Shqipërisë dhe Ligjin nr. 80 datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.</p> <p>Sikurse shënohet në Nenin 3/d të Statutit të UAMD “... të përgatisë profesionistë dhe qytetarë aktivë për shoqërinë demokratike shqiptare dhe vlerat evropiane.”</p> <p>Në deklaratën e qëllimit të UAMD Neni 4 theksohet se UAMD ka qëllim “... zhvillimin e arsimit, kulturës, shkencës dhe ekonomisë, në shërbim të lirisë dhe diversitetit të ideve, për ndërtimin dhe konsolidimin e shoqërisë demokratike dhe shtetit ligjor për rritjen e mirëqenies dhe dinjitetit njerëzor të realizuar me veprimtari të ligjshme dhe transparente.”</p> <p>Sipas Statutit, UAMD ofron programe studimi të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite në përputhje me Sistemin Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS). Ato bazohen në “... vlerësimin e nevojave duke ndjekur dinamikën e tregut të punës”.</p> <p>Programi i studimit “Master Profesional “Multimedia dhe Televizion Dixhital” me profile: a) Produksion dhe Post-Produksion; b) Animim 3D; c) Përpunimi imazhi” është ndërtuar bazuar në këtë qëllime që janë të vendosura në dokumentet e sipërcituara.</p> <p>Dhjetëvjeçari i dytë i shekullit të 21-të në fushën e mediave audiovizive është konsideruar si përfundimi i dixhitalizimit. Pas disa afateve të vendosur e të tejkaluara, edhe Shqipëria hyri në fazën e kalimit të transmetimeve nga analoge në dixhitale dhe kjo ka përkuar edhe me nevojat e reja të tregut të punës për transmetimet dixhitale.</p> <p>Gjatë këtij dhjetëvjeçari ka pasur edhe ndryshime në legjislacionin për mediat audiovizive me miratimin e Ligjit Nr. 97/2013 për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë, (Ndryshuar me Ligjin nr. 22/2016 datë 10.3.2016, Ndryshuar me Vendimin nr. 56 datë 27.07.2016 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë dhe me Ligjin nr. 91/2017).</p> <p>Më 31 tetor 2019 u finalizua procesi i digjitalizimit në qarqet Tiranë dhe Durrës, duke e çuar në pesë numrin e qarqeve në rang vendi, ku tashmë janë mbyllur transmetimet analoge. Me kalimin në transmetimet numerike në këto qarqe, ku</p>
<b>Kriteri 2</b> Programet e studimit synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	
<b>Kriteri 3</b> Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	
<b>Kriteri 4</b> Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

	<p>është përqendruar numri më i madh i banorëve, rreth 80% e popullsisë tashmë ka akses në transmetimet digjitale.</p> <p>Të gjitha këto elemente të mësipërm, si faza të zhvillimit aktual të vendit, janë të lidhura edhe me nevojën e përgatitjes së forcave të punës për të hyrë në treg, të cilat reflektohen edhe në hapjen e programeve të reja mësimore në ciklet e ndryshme të studimit.</p> <p>Programi i studimit “Master Profesional “Multimedia dhe Televizion Dixhital” me profile: a) Produksion dhe Post-Produksion; b) Animim 3D; c) Përpunimi imazhi” është ndërtuar në përmbushje të plotë me misionin dhe qëllimin e tij dhe në ruajtje të interesave kombëtare</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Niveli i përmbushjes</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi I.2</b>	
<b>Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	UAMD ka të ndërtuara programe në të tre ciklet e studimit. Për secilin nga këto programe njësitë përgjegjëse kanë hartuar kurikula të cilat mishërojnë Statutin e tij, misionin dhe qëllimin e këtij institucioni të arsimit të lartë. Njësia Kryesore e Teknologjisë së Informacionit, në shtator 2018, hartoi një Plan Zhvillim Strategjik 2018-2022 si një drejtues për rrugën e zhvillimit të programit “Master Profesional “Multimedia dhe Televizion Dixhital” me profile: a) Produksion dhe Post-Produksion; b) Animim 3D; c) Përpunimi imazhi”. Plani Strategjik koordinon punën dhe aktivitetet kërkimore shkencore për ti qëndruar besnik vlerave të UAMD.
<b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Njësia Bazë e Teknologjisë së Informacionit ofron në ciklin e parë Bachelor 3 (tre) programe: 1. Teknologji Informacioni; 2. Sisteme Informacioni; 3. Multimedia dhe Televizion Dixhital. Kjo Njësi, duke studiuar tregun e punës dhe ecurinë e zhvillimeve të vendit drejt një procesi dixhitalizimi, ofroi hapjen e një program në nivelin e dytë të Masterit Profesional në Multimedia dhe Televizion Dixhital.
<b>Kriteri 3.</b> Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.	Plan Zhvillim Strategjik 2018-2022 saktëson se “... Programet e studimeve që ofron DTI kanë objektiva të përcaktuara qartë për formimin e studentëve, ku përfshihen dijet, aftësitë e fituara dhe kompetencat profesionale. Studentët mësojnë si të vlerësojnë teknologjitë aktuale dhe ato në zhvillim; të identifikojnë nevojat e përdoruesve; të projektojnë ndërfaqe për përdoruesit; aplikojnë, konfigurojnë dhe menaxhojnë teknologji të ndryshme bashkëkohore; dhe të vlerësojnë ndikimin e teknologjisë tek individët, organizatat dhe shoqëritë. DTI ofron kurikula ndërdisiplinore duke u fokusuar kryesisht në teknologjitë e informacionit.”
<b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit të ciklit të dytë “Master profesional” hartohen e zhvillohen në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit.	Synimi i programit të MP ka për qëllim të përgatisë studentë të aftë praktikisht të cilët do të shërbejnë si specialistë/teknikë në fushën e animimit 3D, produksionit dhe postproduksionit dhe përpunimit të imazhit, si profesionistë në tregun e punës. Këto synime janë në përputhje me misionin dhe vizionin e UAMD si në veprimtarinë akademike ashtu edhe njohuritë praktike në fushën e ekspertizës. Edhe elementët organizativë, emërtimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit janë në përputhje me drejtimit akademike të

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

	institucionit. Rregullorja e programit e miratuar në vitin 2018, në Kreun II të saj rendit organet drejtuese: (i). Departamenti i Teknologjisë së Informacionit; (ii). Koordinator i Programit Master Profesional. Të dy këto organe drejtuese kanë kompetenca të përcaktuara. Rregullorja jep gjithashtu edhe strukturën e studimeve, programit mënyrën e kontrollit dhe vlerësimit të dijeve deri në marrjen e diplomës.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi I.3</b>	
<b>Programet e studimit “Master profesional” synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me nevojat dhe kërkesat e tij.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit “Master profesional” kanë objektiva të përcaktuara qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.	<p>Bazuar në rregulloren e Programit të studimit Master Profesional ka si mision të pajisë studentët me trajnim të thelluar profesional, pasi ka përfunduar një program studimesh universitare prej së paku tre vitesh (Bachelor) në fushën e Multimedias dhe Televizion Dixhital, Sistemeve të Informacionit, Teknologjisë së Informacionit, Inxhinierisë Elektronike, Inxhinierisë Informatike, Informatikë.</p> <p>Cikli i studimeve Master Profesional në “Multimedia dhe Televizion Dixhital” është program studimi 1 vjeçar me kohë të plotë, me frekuentim të detyrueshëm, i cili merr përsipër të ofrojë studime të thelluara në disiplinat e multimedias.</p> <p>Rregullorja gjithashtu përcakton edhe se programi synon:</p> <p>a) Të ofrojë një trajnim të plotë teknik në fushat e mëposhtme: përpunimit të imazhit, animimit 3D, produksionit dhe postproduksionit;</p> <p>b) Të sigurojë që njohuritë dhe aftësitë e fituara në këtë program të kualifikojnë studentët për sfida të ndryshme praktike në profesionin e tyre dhe t'i aftësojnë ata për të kontribuar në risitë e ardhshme teknologjike në fushën e multimedias;</p> <p>c) Të zhvillojë aftësitë teknologjike, duke marrë parasysh mjetet më të përshtatshme për materialet multimediale;</p> <p>d) Të aftësojë studentët në dizejnimin dhe zhvillimin e produksioneve multimediale, sidomos në mediat radio-vizive; e) Të sigurojë efektivitetin dhe interaktivitetin e produksioneve të ndryshme multimediale;</p> <p>f) Të kombinojë njohuritë teorike dhe praktike të fushës së multimedias për të realizuar detyra të ndryshme;</p> <p>g) Të japë njohuri teorike mbi përpunimin dixhital të sinjalit shumëdimensional në fushën e imazheve (2D) dhe video (3D);</p> <p>h) Të aftësojë studentët për të analizuar dhe zbatuar teknika të ndryshme të kodimit dhe kompresimit të imazhit;</p> <p>i) Të përgatitë studentët për të vazhduar progresin në fushën e kërkimit e kualifikimit më të avancuar shkencor.</p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe	UAMD ka hartuar një studim për tregun e punës bazuar në nevojat për profesionistë në fushën e mediave audiovizive në Shqipëri dhe në Kosovë. Grupi i punës ka studiuar kurikulat edhe në Kosovë në programet e tyre. Grupi ka hartuar një pyetësor në gjuhën shqipe dhe në anglisht dhe është

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@asca.al

Web site: [www.asca.al](http://www.asca.al)

6

<p>në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>zhvilluar në formatet: Word dhe Excel. Gjithashtu janë përdorur edhe "Google Forms" për ta prezantuar dhe shpërndarë pyetësorin tek studentët bachelor dhe alumni, dhe pjesa tjetër e të anketuarve.</p> <p>Në rastin e industrisë MTVD ka disa karakteristika të veçanta si numri i organizatave/kompanive ekzistuese, dhe në disa raste edhe dëshira e munguar për të dhënë informacion për shkak të konkurrencës. Një pjesë e informacionit tjetër është marrë edhe nga anketimet që ka zhvilluar Autoriteti i Mediave Audiovizive.</p> <p>Programi i Multimedia &amp; TV Digital në ciklin e parë të studimit Bachelor është hapur që në vitin 2012 në UAMD dhe ka pasur 180 studentë të regjistruar ndër vite. Në studimin për tregun e punës u anketuan 72 pjesëmarrës nga ky program. Një pyetësor tjetër iu dërgua studentëve dhe të diplomuarve të Universitetit Epoka dhe u hartua sipas të njëjtave parime të UAMD-së. Numri i pjesëmarrësve ishte 77 dhe programi i tyre i studimeve ishte ose Inxhinieri Kompjuterike (CEN) ose Elektronikë dhe Inxhinieri e komunikimeve digjitale (EDCE).</p> <p>Nga përgjigjet e studimit në pyetjet e para rezultonte se pyetjes "Përse zgjedhin këtë program studimi?" - shumica e studentëve deklaruan se e zgjedhin këtë fushë sepse e kishin pasion.</p> <p>Anketimet u plotësuan edhe me pyetje të tjera. Një pyetësor u shpërnda edhe nëpërmjet AMA-s për operatorët e mediave audiovizive. Sipas AMA, 60-80% e ekspertëve në shërbimet multimediale që punojnë në operatorë të ndryshëm kanë një diplomë bachelor. Për shkak të procesit të digjitalizimit ka një rritje në programet audiovizive të ofruara nga operatorët dhe kjo rrit nevojën për ekspertët e MTVD. Për më tepër, operatorët në Shqipëri nuk kanë staf të mjaftueshëm të kualifikuar për të mbuluar nevojën për animim 3D, produksion/post produksion dhe shërbime të përpunimit të imazhit. Sipas AMA, tre janë sfidat që hasin operatorët e medias:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Probleme financiare. Tregua aktual i medias ka një numër mjaft të madhe operatorësh audiovizivë e cila bën që burimet financiare për të mbuluar shpenzimet, të jenë të limituara;</li> <li>▪ Konkurenca në treg bën që operatorët të investojnë me shumë në teknologji, e cila po ndryshon me hapa të shpejtë;</li> <li>▪ Mungesa e stafefë të kualifikuara teknike në menaxhimin me efikasitet të transmetimeve audiovizive.</li> </ul> <p>Informacioni i mbledhur nga anketimet dhe diskutimet solli hapjen e programit të "Master Profesional "Multimedia dhe Televizion Dixhital" me profile: a) Produksion dhe Post-Produksion; b) Animim 3D; c) Përpunimi imazhi".</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Objektivat formues struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit garantojnë përfundimin e dijeve, aftësi, shkathtësi e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Përmbajtja e programeve të lëndëve të "Master Profesional "Multimedia dhe Televizion Dixhital" me profile: a) Produksion dhe Post-Produksion; b) Animim 3D; c) Përpunimi imazhi" është e ndarë në dy semestra dhe me total 60 kredite. Lëndët sipas programit të vitit 2018-2019 janë:</p> <p>Lënda Bazë A - Matematikë për Multimedia</p> <p>Lënda Karakterizuese B</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Teknologjitë e Avancuara në Multimedia</li> <li>▪ Laborator për Multimedia</li> <li>▪ Seminar në Multimedia</li> </ul> <p>Lënda Ndërdisciplinore/ Integruese C</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Produksioni i Filmit dhe Medias</li> <li>▪ <b>Efektet Vizuale/</b> Korrektimi dhe Editimi i Ngjyrave</li> <li>▪ <b>Editimi dhe Masterizimi Audio/Audio 3D</b> në Multimedia</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <b>Kompresimi i Përmbajtjes Multimediale, Sinkronizimi dhe Transferimi/</b> Editim i Avancuar Video.</li> </ul> <p>Lënda Plotësuese D - Menaxhim Projektsh Programi përfundohet me një Provim Diplomimi Si lëndët e karakterizuese B ashtu edhe ato ndërdisiplinore C janë mjaft të përshtatshme me njohuritë që nevojiten në tregun e punës për profesionet të cilat janë synuar nga ky program i Masterit Profesional në MTVD.</p> <p>Ristrukturimi i kurikulës ekzistuese në ciklin e parë të studimeve Bachelor, zhvillimi i kurikulës dhe fillimi i programit të Master Profesional në Multimedia dhe televizionin dixhital dhe ndërtimi i një studio profesionale MTV janë objektivat specifike të projektit</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimeve përafrohen me programe studimi të ngjashme të ofruar nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.</p>	<p>Programi i studimit “Master Profesional “Multimedia dhe Televizion Dixhital” me profile: a) Produksion dhe Post-Produksion; b) Animim 3D; c) Përpunimi imazhi” është ndërtuar bazuar në një bashkëpunim me disa universitete të tjera që kanë programe të ngjashme. Kjo është e shprehur edhe në marrëveshjet e bashkëpunimit të nënshkruara me:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ VSB-Universiteti Teknik i Ostravës (VSB-TUO)</li> <li>▪ Universiteti Tartu (UT) për periudhën 2018-2020</li> <li>▪ Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT)</li> </ul> <p>Edhe fillimi i hapjes së programit Bachelor është bërë në bashkëpunim me shkolla dhe universitetet në kuadër të programit TEMPUS.</p> <p>Për hapjen e programit të Master Profesional në MTVD Universiteti UAMD dhe NJBIT janë leader të një tjetër programi të financuar me fondet e Erasmus + DIMTV PROJECT No: 586318-EPP-1-2017-1-AL-EPPKA2-CBHE-JP. <a href="http://dimtv-project.al/">http://dimtv-project.al/</a></p> <p>Strategjia e UAMD është të hartojë programe studimi në perputhje me Kartën e Bolonjës. Kurrikula dhe syllabuset e lëndëve janë hartuar që të jenë sa më të përafërta me universitetet brenda dhe jashtë vendit. Syllabuset e ofruara në këtë program studimi për të 3 profilet janë të strukturuar në bashkëpunim me partnerët europianë. Gjithashtu, institucioni deklaron që një pjesë e lëndëve janë përgatitur me përmbajtje të njëjtë me Universitetin Epoka dhe UBT, Prishtinë me qëllim që në një të ardhme të kenë programe të përbashkëta dhe lehtësim për transferim studimesh.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit hartohen në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara mbështeten në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikën e mira të vendeve evropiane.</p>	<p>Programi është hartuar pas një projekti Project No: 586318-EPP-1-2017-1-AL-EPPKA2-CBHE-JP të titulluar Development And Implementation Of Multimedia And Digital Tv Curricula (DIMTV).</p> <p>Ky projekt ka ndihmuar në krijimin e laboratorit mjaft mirë të pajisur të Multimedias. Si laborator ai shërben si për studentët e ciklit të parë të studimit në Bachelor në MD ashtu edhe për studentët e MP në MTVD.</p> <p>Profesorë të universiteteve partnere kanë qenë të ftuar “guest lector” në programe duke dhënë seminare të veçanta në disa nga programet e MP. Kjo pasi ata kanë qenë pjesë e projektit, dhe kanë sjellë eksperiencë nga universitetet e tyre. Consorciumi i krijuar përfshin Universitetin e Lubjanës, Slloveni, Universitetin e Tartu, Estonia dhe Universiteti Teknik i Ostravës në Republikën Çeke. Ky konsorcium dhe eksperiencia e këtyre universiteteve janë një premisë shumë e mirë për cilësinë e programit të studimit.</p>



<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e ciklit të dytë “Master profesional” përfshijnë aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.</p>	<p>Aftësimi profesional në këtë program arrihet nëpërmjet një ndërthurje të mirë të lëndëve praktike me njohuritë teorike të fituar gjatë kursit dhe programeve.</p> <p>Programi “Master Profesional “Multimedia dhe Televizion Dixhital” me profile: a) Produksion dhe Post-Produksion; b) Animim 3D; c) Përpunimi imazhi” nuk ka të përfshirë praktikën profesionale si lëndë me vetë. Një nga lëndët mësimore është “Laborator në multimedia” e cila është një ndihmuese shumë për të zbatuar njohuritë praktike.</p> <p>Nga diskutimet me studentët gjatë takimit GVJ mori informacion se ata e vlerësonin shumë pasjen e një studioje televizive të pajisur me teknologji të kohëve të fundit. Zhvillimi i lëndëve praktike në studio i ndihmonte ata shumë në përgatitjen profesionale. Lënda e “Laborator në multimedia” është një komponent shumë i rëndësishëm i kurikulës dhe formimit profesional.</p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Në varësi të profilit të institucionit, në programet e ciklit të dytë “Master profesional” mund të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj dhe ndërkombëtarizimin.</p>	<p>Programi “Master Profesional “Multimedia dhe Televizion Dixhital” me profile: a) Produksion dhe Post-Produksion; b) Animim 3D; c) Përpunimi imazhi” nuk ka lëndë në gjuhë të huaj. Megjithatë, duke qënë se ky program ka mjaft lëndë praktike të cilat përdorin software dhe programe teknike ndërkombëtare, një pjesë e madhe e literaturës është kryesisht në gjuhën angleze.</p> <p>Ndërkohë që për disa nga lëndët teknike, në këtë program Masteri profesional, gjatë vitit akademike 2018-2019 ka pasur leksione edhe nga pedagogë të huaj. Ata kanë dhënë mësim në gjuhën angleze dhe për module të veçanta të saj. Kjo është realizuar falë bashkëpunimit me universitetet partnere në projektin e përbashkët “Development and Implementation of Multimedia and Digital TV Curricula (DIMTV)”.</p>			
<p><b>Kriteri 8.</b> Programet e ciklit të dytë “Master profesional” mund të hapen përkohësisht në funksion të plotësimin të nevojave për personel të kualifikuar në një drejtim të caktuar.</p>	<p>Programi “Master Profesional “Multimedia dhe Televizion Dixhital” me profile: a) Produksion dhe Post-Produksion; b) Animim 3D; c) Përpunimi imazhi” është hapur pas një studimi të tregut të punës dhe anketimeve të zhvilluara me student në ciklin e parë të studimeve Bachelor. Nuk mund të cilësohet nëse kjo është një nevojë e diktuar përkohësisht në këtë profil. Megjithatë studimi i tregut të punës dhe informacioni i marrë nga AMA ka përcaktuar se ka diferencë në përputhjen e arsimit me profilin e punës për stafet teknike të mediave elektronike.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

**Standardi I.4**

**Programet e ciklit të dytë “Master profesional” janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.**

<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>UAMD ka në përbërjen e tij 6 fakultete dhe një nga këto është Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit. Ky fakultet ofron 6 programe në Bachelor njëri nga të cilët është Multimedia &amp; TV Dixhital. Fakulteti ofron 2 programe në Master Profesional dhe një Master Shkencor.</p> <p>Kapacitetet teknike janë të plotësuara në mënyrën më të mirë me dy studio e dedikuara këtij programi, studion kompjuterike dhe studion e televizionit.</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

	<p>Përvoja akademike e fituar në programet e tjera të studimit shfrytëzohet edhe në program. Kjo vlen për profesorët e lëndëve bazë A, për lëndët karakterizuese B dhe to interdisiplinare C.</p> <p>Në raportet e vlerësimit pedagogët kanë eksperiencë në pjesët teknike edhe nga cikli i parë i studimit. Trajnimet e zhvilluara nga stafi në kuadër të projektit “Development and Implementation of Multimedia and Digital TV Curricula (DIMTV)” kanë dhënë informacionin e nevojshëm për të krijuar edhe vazhdimësinë e projektit.</p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Programi i studimit është hapur me profilin tij teknik dhe për rrjedhojë përputhet me targetin e synuar të studentëve që nendohet se do të vazhdojnë studimet në këtë program. NJKTI (Njësia Kryesore e Teknologjisë së Informacionit) ka në drejtimin e saj Prof. As. Lindita Mukli, Dekan dhe dy zëvendës dekanë Doc. Vladimir Muka dhe Dr. Eris Zeqo. Profilët e tyre janë të shkencave ekzakte dhe matematike.</p> <p>Ndërsa NJBTI (Njësia Bazë e Teknologjisë së Informacionit) ka në përbërjen e tyre 14 pedagogë. Sipas evidencës së dhënë “Të dhëna tabelore për personelin akademik në njësinë kryesore dhe bazë” rezultojnë se 7 prej anëtarëve të stafit kanë titullin Doktor i Shkencave.</p> <p>Gjatë vitit, në këtë program studimi janë përdorur si pedagogë të brendshëm edhe pedagogë të jashtëm. Ka një problematikë të stafit me grada shkencore në fushat specifike të teknologjisë së medias, pasi ato janë të limituara. Universiteti është përpjekur ta mbushë këtë boshllëk me pedagogë të jashtëm.</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Institucioni është udhëheqës i një projekti i cili financohet nga BE “Development and Implementation of Multimedia and Digital TV Curricula (DIMTV)” me fonde të “Erasmus +” të cilët ndihmojnë gjithashtu për programin dhe hartimin e kurikulës. Megjithatë cilësia e programit të studimit mbështetet në vetë burimet e brendshme të universitetit.</p> <p>UAMD nuk ofron programe Master Profesional në drejtime të tjera jashtë profilit të institucionit</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Në rastet kur institucioni ofron program të ciklit të dytë “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohej nga institucionet partnere.</p>	<p>Institucioni është udhëheqës i një projekti i cili financohet nga BE “Development and Implementation of Multimedia and Digital TV Curricula (DIMTV)” me fonde të “Erasmus +” të cilët ndihmojnë gjithashtu për programin dhe hartimin e kurikulës. Megjithatë cilësia e programit të studimit mbështetet në vetë burimet e brendshme të universitetit.</p> <p>UAMD nuk ofron programe Master Profesional në drejtime të tjera jashtë profilit të institucionit</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	


<p><b>Standardi I.5</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>UAMD ka një strukturë organizative të miratuar (Evidenca 49 në listën e dokumenteve të përcjella nga RVB të UAMD) për secilin nga fakultetet e tij. Organigrama e UAMD përcakton qartë varësinë dhe linjat e vendimmarrjes për realizimin e misionit dhe synimeve të universitetit për edukimin e studentëve. Statuti i UAMD miratuar me vendimin e Senatit Akademik Nr. 33 datë 20.04.2018, Rregullorja e UAMD miratuar me vendimin e Senatit Akademik Nr. 154 datë 26.11.2018 dhe Rregullorja e NJKTI kanë të përcaktuar procedurat e punës dhe bashkëpunimit midis njësisë kryesore, si</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

10




	<p>edhe ndarjen e detyrave për mbarëvajtjen e programeve të studimit. Rregullorja e programit të studimit për programin e studimit të ciklit të dytë Master Profesional “Multimedia dhe Televizion Dixhital” miratuar në 2018 në kreun e dytë “Organizimi dhe Drejtimi i Programit të Studimeve Master Profesional në “Multimedia dhe Televizion Dixhital”” përshkruan saktësisht organizimin dhe detyrat për stafin akademik, koordinatorin e programit, sekretarinë mësimore.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>UAMD ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me mjaft universitete të tjera në Shqipëri dhe universitete të huaja për të rritur bashkëpunimin në funksion të edukimit të studentëve.</p> <p>Në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm dhe në evidencat dokumentare të paraqitura nga Universiteti jepet tabela përmbledhëse e marrëveshjeve të nënshkruara (i) Tabelë përmbledhëse me institucionet bashkëpunuese, për programin e studimit dhe për praktikën profesionale (Marrëveshjet për MDTV); si edhe (ii) Marrëveshjet e bashkëpunimit (aktive) me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj dhe për praktikën profesionale.</p> <p>Nënshkrimi i marrëveshjeve në shkallë universiteti koordinohet nga Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Projekteve e cila bashkëpunon me njësitë kryesore dhe bazë të secilit fakultet dhe program studimi për realizimin e tyre.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programeve të ciklit të dytë “Master profesional”, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute, kompani, të fushës përkatëse, për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>Për realizimin e Programit “Master Profesional “Multimedia dhe Televizion Dixhital” UAMD ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me disa institucione homologe brenda dhe jashtë vendit dhe aktorë të biznesit vendas. NJKTI ka marrëveshje të nënshkruar me Radio Televizionin Publik Shqiptar si një ndër institucionet e mëdha mediatike. Ky institucion i shërben si marrjes së informacioneve praktike nga tregu i punës ashtu edhe për marrjen e trajnerëve dhe specialistëve të ftuar në leksione të hapura gjatë programit mësimor. Lista e plotë e marrëveshjeve të nënshkruara me institucionet e tjera gjendet në evidencat e dhëna nga universiteti në procesin e akreditimit.</p> <p>Programi “Master Profesional “Multimedia dhe Televizion Dixhital”” në UAMD është ndërtuar në bashkëpunim me Universitetin e Lubjanës, Slloveni, Universitetin e Tartu, Estoni dhe Universitetin Teknik të Ostravës në Republikën Çeke. Këto universitete së bashku kanë krijuar një konsorcium bashkëpunim dhe kanë aplikuar në programin Erasmus + që ka financuar edhe ngritjen e këtij program studimi.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimit që ofron.</p>	<p>UAMD ka marrëveshje bashkëpunimi për realizimin e praktikave mësimore në varësi të programeve të studimit të cilat kanë praktikën të përfshirë në kurikula.</p> <p>Programi “Master Profesional “Multimedia dhe Televizion Dixhital” në UAMD nuk ka të planifikuar praktikë mësimore si pjesë e programit të studimit.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Programi “Master Profesional “Multimedia dhe Televizion Dixhital” në UAMD është hapur në vitin akademik 2018-2019 dhe për rrjedhojë, të diplomuarit e këtij viti janë të parët e këtij programi studimit. Gjatë vitit të parë të studimit ka pasur lektorë vendas dhe të huaj të ftuar në seminare të veçanta dhe për tematika të ndryshme që lidhen me anën profesionale të studimeve në multimedia dhe televizion. Gjatë programit mësimor ka pasur lektorë të ftuar që kanë zhvilluar workshop dhe kanë pajisuar me certifikata studentët pjesëmarrës.</p> <p>Edhe gjatë vizitës së GVJ shiheshin postera për trajnim për fortografinë që do të realizohen në javën e fundit të nëntor 2019 me një fotograf profesionist.</p>

<p><b>Kriteri 6.</b> Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>NJBTI raporton për fazat e projektit dhe rezultatet e arritura gjatë fazave të veçanta në kuadër të projektit Erasmus +. Në kuadër të projektit plotësohet një pyetësor specifik i cili përdoret për raportimin për ecurinë e projektit. Pyetësori anketon studentët për ecurinë e deritanishme të programit dhe kurikulës mësimore. Formatet e pyetësorëve gjenden në listën e dokumenteve të dhëna në dosjen e akreditimit të programit.</p> <p>Raportet analitike të përfitimeve nga projekti i bashkëpunimit në konsorciumin me universitetet e huaja janë në formatin e projekteve. Ndërkohë, sic cilësohet në RVB, NJBTI po punon për hartimin e modeleve të raportimit në lidhje me procesin mësimdhënies dhe sidomos veprimtarive të lidhura me studentët.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>


## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER PROFESIONAL

<b>Standardi II.1 Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi “Master Profesional “Multimedia dhe Televizion Dixhital” në UAMD është i ndërtuar për një vit akademik me 60 kredite ECTS dhe me kategori Programi “Master Profesional “Multimedia dhe Televizion Dixhital” të disiplinave mësimore A, B, C, D dhe E. Programi nuk ka module, por lëndë mësimore. Secila lëndë ka të përcaktuar qartë syllabusin e saj, kreditet që ajo ka dhe mënyrën e vlerësimit në përfundim të saj. Numri i krediteve për secilën lëndë mësimore është i barabartë me 6 ECTS dhe po kështu edhe numri i orëve mësimore në auditor dhe të pavarura. Në semestrin e parë janë të grupuara kryesisht lëndët e kategorisë së disiplinës A dhe B. Program zhvillohet në dy semestra të cilët kanë numër të barabartë kreditesh të lëndëve, 30 ECTS secili semester. Mësimi realizohet nëpërmjet dhënies së orëve teorike dhe praktike (detyra kursi, prezantime, projekte teknike, etj)</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimit të ciklit të dytë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p>Programi “Master Profesional “Multimedia dhe Televizion Dixhital” ka disa lëndë sidomos ato të kategorisë B dhe kategorisë C të cilat formojnë tek studentët aftësi të veçanta të nevojshme për profesionet në tregun mediatik shqiptar. Lëndë të tilla si “Produksioni i Filmit dhe Masedias”, “Efektet Vizuale”, “Editimi dhe Masterizimi Audio” dhe “Kompresimi i Përmbajtjes Multimediale, Sinkronizimi dhe Transferimi” japin njohuritë e nevojshme dhe krijojnë edhe shprehitë profesionale për teknikienë në median elektronike. Për të ë përgatitur studentët për mediat e reja në kohën dixhitale shërbejnë edhe “Seminar në multimedia” gjatë së cilës jepen praktikat dhe programet e nevojshme specifike në media. Lëndët e kategorisë B kanë të ndërthurur elementet teorikë me ata praktikë. Edhe lënda “Teknologjitë e avancuara në multimedia” jep informacione teorike të nevojshme për studentët.</p>
<p><b>Kriteri 3</b> Programet e studimit të ciklit të dytë japin njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>NJBTI ka kryer një studim për tregun e punës dhe kërkesat potenciale për profesione të tilla në mediat elektronike në vend. Studimi ka përfshirë informacione edhe nga Autoriteti i Mediave Audiovizive dhe anketime të studentëve dhe pjesëmarrësve në tregun e punës. Diskutimi me studentët gjatë vizitës së GVJ tregoi edhe drejtimet që ata kishin marrë në punësimin e tyre dhe mundësitë e ofruara. Studentët ishin të punësuar në televizione dhe radio, në zyra të marrëdhënieve publike për biznese private, agjenci publicitare, etj. Lëndët synojnë të japim kompetencat profesionale të nevojshme për studentët që ata të jenë në gjendje të përballojnë problematika profesionale gjatë punës së tyre.</p>
<p><b>Kriteri 4</b> Programet e studimit të ciklit të dytë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>NJBTI ka kryer një studim për tregun e punës dhe kërkesat potenciale për profesione të tilla në mediat elektronike në vend. Studimi ka përfshirë informacione edhe nga Autoriteti i Mediave Audiovizive dhe anketime të studentëve dhe pjesëmarrësve në tregun e punës. Diskutimi me studentët gjatë vizitës së GVJ tregoi edhe drejtimet që ata kishin marrë në punësimin e tyre dhe mundësitë e ofruara. Studentët ishin të punësuar në televizione dhe radio, në zyra të marrëdhënieve publike për biznese private, agjenci publicitare, etj. Lëndët synojnë të japim kompetencat profesionale të nevojshme për studentët që ata të jenë në gjendje të përballojnë problematika profesionale gjatë punës së tyre.</p>
<p><b>Kriteri 5</b> Programet e studimit të ciklit të dytë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Programi “Master Profesional “Multimedia dhe Televizion Dixhital” ka hartuar Rregulloren për këtë program specific studimi. Në rregullore, të ndarë në tetë kapitujt (Kreu I-VIII) janë zbatuar kërkesat e Vendimit nr.41, datë 24.01.2018 për elementët e nevojshme të përcaktuar të studimit të ofruar. Këto element janë të përcaktuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Kreditet janë të ndërtuara sipas sistemit ECST;</li> <li>▪ Kontrolli i dijeve dhe instrumentat e vlerësimit janë të ndërthurur nëpërmjet testeve me shkrim, detyrave praktike dhe prezantimeve në grup dhe individuale dhe tezave të diplomës;</li> <li>▪ Objektivat formuese dhe profesionale janë të saktësuar sipas detyrimeve ligjore;</li> </ul>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

13  




	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit janë të ndara në orë auditori, punë individuale, veprimtari praktike, provim diplome;</li> <li>▪ Plani mësimor dhe program lëndor (<i>syllabus-et</i>) janë të përcaktuar qartë;</li> <li>▪ Programi është ndërtuar me tre profile të ndryshme;</li> <li>▪ Rregullorja përcakton qartë procedurat e pranimit;</li> <li>▪ Studenti ka të përcaktuar formatin e Diplomës dhe të Supplementit.</li> </ul>								
<b>Kriteri 6</b> Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët/modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Programi “Master Profesional “Multimedia dhe Televizion Dixhital” me profil Produksion dhe Post-Produksion ka këto kategori lëndësh: A – Lëndë Bazë -10% B – Lëndë Karakterizuese -40% C – Lëndë Ndërdisciplinore -30% D – Lëndë Plotësuese -10% E – Detyrime Përmblyëse -10% Kjo ndarje respekton Vendimin nr. 41 për ndarjen e krediteve në Master Profesional								
<b>Kriteri 7</b> Programet e studimit parashikojnë ngarkesën në kredite të dedikuara për praktikën profesionale, laboratorike e klinike me ekuivalentim sipas përcaktimeve në aktet nënligjore kombëtare dhe në përputhje me direktivat evropiane.	Programi “Master Profesional “Multimedia dhe Televizion Dixhital” me profil Produksion dhe Post-Produksion nuk parashikon kredite për praktikën mësimore apo laboratorë si lëndë e veçantë. Megjithatë program i ka të ndërthurur elementët e praktikës në secilën nga Lëndë Karakterizuese B dhe Lëndë Ndërdisciplinore C. Programi ka një laborator shumë mirë të pajisur me teknologji të avancuar për multimedia. Këtu studentët kryejnë praktikën e ndërthurur me prezantimet e tyre me projekte specifike. Studiot e multimedias janë ndërtuar në bashkëpunim me projektin e financuar nga BE “Development and Implementation of Multimedia and Digital TV Curricula (DIMTV)” me fonde të “Erasmus +”								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Niveli i përmbushjes</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<b>Standardi II.2</b>	
<b>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	Programi “Master Profesional “Multimedia dhe Televizion Dixhital” oranzizohet në Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit (FTI), një ndër 6 (gjashtë) fakultetet e UAMD. Sikurse është e përcaktuar edhe në Statutin e Universitetit janë të ndara funksionet dhe detyrat, struktura organizative funksionet e kërkimit shkencor, kodet e etikës dhe elementët e tjerë të nevojshëm nga pikëpamja organizative.
<b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	Universiteti ka kaluar akreditimin institucional. Njësia Kryesore e Teknologjisë së Informacionit ka në përbërjen e saj 3 (tre) njësi bazë: <ul style="list-style-type: none"> <li>- Njësia Bazë e Shkencave Kompjuterike;</li> <li>- Njësia Bazë e Matematikës;</li> <li>- Njësia Bazë e Teknologjisë së Informacionit</li> </ul>

	Njësia Bazë e Teknologjisë së Informacionit (NJBTI) përmbush detyrimet për organizimin dhe strukturën akademike. Programi ka kordinatorin e tij, stafin akademik dhe ndihmës.			
<b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.	Njësia Bazë e Teknologjisë së Informacionit (NJBTI) ku është i organizuar program “Master Profesional “Multimedia dhe Televizion Dixhital” ka 14 anëtarë efektiv si staff akademik. Nga ky personel akademik 7 kanë gradën Doktor. Ndërsa si fakultet, Njësia Kryesore e Teknologjisë së Informacionit (NJBTI) me të tre njësitë bazë, ku përfshihet edhe TI janë 49 staff akademik të ndarë përkatësisht sipas titujve: Prof. Assoc. Dr. 1 staff; Doktor 20 staff; Doc 3; dhe 25 staff me Master.			
<b>Kriteri 4.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	Njësia Kryesore e Teknologjisë së Informacionit (NJBTI) për vitin mësimor 2018-2019 ka pasur një ngarkesë mësimore sipas orëve me ngarkesë leksione dhe seminare duke realizuar edhe orë suplementare mbi ngarkesën e përcaktuar nga udhëzimi nr. 29 datë 10.09.2018. Sipas RVB, në Njësinë Bazë të TI janë 15 anëtarë staff me kohë të plotë dhe 15 me kohë të pjesëshme. Stafii me kohë të pjesëshme mbulon 20% të totalit të orëve të mësimit kurse stafi me kohe të plotë 80%. Përsa i takon pedagogëve që japin mësim programin e studimit “Master Profesional “Multimedia dhe Televizion Dixhital” me profil Produksion dhe Post-Produksion për vitin 2019-2020 ata janë të gjithë pedagogë të brendshëm të departamentit. Në vitin mësimor 2018-2019 ka qenë vetëm një pedagoge e Fakultetit të Biznesit e cila ka dhënë lëndën e Menaxhimit të Projekteve, lëndë e detyrueshme në semestrin e parë e kategorisë B. Të gjithë pedagogët që japin mësim MP në “Multimedia dhe Televizion Dixhital” kanë gradën Dr. Ose me shumë.			
<b>Kriteri 5.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike.	Programi “Master Profesional “Multimedia dhe Televizion Dixhital” me profil Produksion dhe Post-Produksion nuk realizon praktikë mësimore, laboratorë dhe klinika. Për rrjedhojë nuk angazhon si personel ndihmës të dedikuar atyre. Studiot e Multimedis në UMAD kanë një personel ndihmës që menaxhon mbarëvajtjen e studios dhe bashkëpunon me studentët në realizimin e detyrave praktike, prezantimeve filmike, projekteve mediatike, etj.			
<b>Kriteri 6.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e kordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Njësia Bazë e Teknologjisë së Informacionit ka caktuar si kordinator të programit “Master Profesional “Multimedia dhe Televizion Dixhital”, Dr. Luciana Toti, njëkohësisht edhe drejtuese e kësaj njësie. Pozicioni i kordinatorit ka të përcaktuar edhe detyrat specifike në kuadër të programit të cilat janë të miratuara në Rregulloren e Programit të Studimit, nenet 9 dhe 10.			
<b>Kriteri 7.</b> Koordinator i programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit.	Kordinatori i programit “Master Profesional “Multimedia dhe Televizion Dixhital” raporton te Përgjegjësi i Njesisë, që është edhe në funksionin e Dekanit të fakultetit të Teknologjisë së Informacionit. Raportimi bëhet si për ecurinë e programit dhe procesit mësimor, vlerësimet e tij nga studentët dhe organizmat partnere dhe në kuadrin e projektit të përbashkët.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

**Standardi II.3**

**Programet e studimit të ciklit të dytë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe të organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të dytë.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Njësia Bazë e Teknologjisë së Informacionit pranë Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit disponon informacionin e duhur për strukturimin e programit MP në "Multimedia dhe Televizion Dixhital". Programi i studimit është i ndërtuar me lëndë të katërkohëve A, B, C, D, E dhe i ndarë në orë mësimore. Studentët në program fitojnë 60 ECTS të ndara në dy semestra përgjatë një viti kalendarik, me 32 javë mësimore në auditorë. Secila nga lëndët ka numër të barabartë kreditesh prej 6 ECTS për secilën nga 10 lëndët e programit. Studnetët në përfundim të ciklit mësimor të programit japin edhe një provim përfundimtar. Për vitin akademik 2019-2020 po mendohet që provimi përfundimtar të jetë një projekt mediatik që do të jetë kurorëzimin punës dhe njohurive të studnetëve.
<b>Kriteri 2.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	
<b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.	
<b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.	Programi MP në "Multimedia dhe Televizion Dixhital" ka të dokumentuar të gjitha syllabuset e lëndëve. Në to janë dhënë të detajuara Titullarin e lëndës, Ngarkesën mësimore në kredite, dhe orë mësimore, Tipologjia e lëndës sipas klasifikimeve dhe llojin në kurs të detyrueshëm apo me zgjedhje. Në program jepen konceptet kryesore, tematikat që do të trajtohen Në syllabus jepen edhe forma e frekuentimit dhe e kontrollit të dijeve dhe mënyrat e vlerësimit dhe pikëzimit të studnetit. Syllabuset kanë edhe adresën elektronike e titullarit të lëndës.
<b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Sekretaria mësimore i ofron studentëve informacionin e nevojshme për procedurat dhe rregullat që duhet të ndjekin në rast të transferimit të studimeve dhe ekuivalentimit të krediteve që ata kanë marrë në një program studimi. Gjithastu sekretariatit nësimore japin informacion edhe për orarin, sezonet dhe datat e provimeve etj. Politikat e pranimit janë të shpallura që në përfundim të vitit të mëparshëm mësimor për kriteret e përgjithshme dhe specifike të regjistrimit në programet e studimit.
<b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Syllabuset janë të plota, më të gjithë elementët: <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Përmbledhjen dhe rezultatet e të nxënit;</li> <li>▪ Konceptet themelore;</li> <li>▪ Orët në auditor dhe si punë individuale;</li> <li>▪ Temat e programit mësimor të lëndës specifike;</li> <li>▪ Formën e kontrollit të dijeve;</li> <li>▪ Literaturën; etj</li> </ul> Të gjithë këto elementë përputhen me formatet e miratuara në fuqi.
<b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Viti 2018-2019 ka qënë viti i parë kur është zhvilluar ky program mësimor. Programi është ndërtuar edhe bazuar në eksperiencat e universiteteve të huaja. Gjatë vitit të dytë këtij programi studimi, është në diskutim që për provimin e diplomimit, mund të përdoret edhe një program mediatik, projekt, pra një prodhim konkret për të përfshirë të gjithë elementët dhe njohuritë e fituara gjatë vitit.

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

26



Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

#### Standardi II.4

**Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Programi i studimit Master Profesional “Multimedia dhe Television Dixhital” është i ndërtuar në një vit akademik, me dy semestra dhe 60 kredite të shpërndara njëtrajtësisht në mwnyrë të barabartë midis lëndëve. Ngarkesa e programit është e strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi.
<b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë thellim të njohurive dhe aftësive dhe/ose punësimin e studentëve.	Programi Master Profesional “Multimedia dhe Television Dixhital” ka një shpërndarje të lëndëve midis dy semestrave, ku në semestrin e parë jepen njohuritë kryesore teorike dhe në semestrin e dytë kushtohet më shumë kohe studimi dhe pune në laboratorin e multimedias. Emërtimet e lëndëve janë në përputhje me objektivat formuese të programit. Gjithashtu edhe shpërndarja e veprimtarive praktike brenda programeve mësimore ndihmon në aftësimin e studentëve me njohuri teorike e praktike që i jep avantazhe krahasuese për tu punësuar në treg.
<b>Kriteri 3.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.	Forma e kontrollit të dijeve është në përputhje me procedurat ligjore. Më poshtë jepet një analizë e lëndëve sipas semestrave dhe syllabuseve të tyre për programin e studimit Master Profesional “Multimedia dhe Television Dixhital”: Semestri I 1. Matematikë për Multimedia - Kategoria A, me 6 ECTS, lëndë e detyrueshme.
<b>Kriteri 4.</b> Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teoripraktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	Sipas syllabusit të përgatitur për këtë program “Qëllimi i kursit është të plotësojë formimin matematikor bazë të përfituar në studimet e ciklit të parë, plotësimi i teorisë së variablave kompleksë dhe ilustrimi i detajuar i teknikave matematikore më të përdorura në aplikimet inxhinierike (Furie dhe Laplas) dhe trajtimin numerik të problemeve diferenciale.” Lënda është e kategorisë bazë për përgatitje metodologjike dhe kulturë të përgjithshme dhe përmban 15 tema (pa përfshirë provimin përfundimtar dhe zgjidhjen e tezës së provimit). Temat përgjithësisht lidhen me matematikën hapsirën e vektorëve algjibrën e matricave gjeometrinë 3D, derivatet, ekuacionet diferenciale. Po kështu janë edhe temat lidhur me transformimet Fourier, Laplace, walvet, metodat interactive për sistemet lineare, metodat e gradientit të kushtëzuar, Metodat MINRES dhe GMRES. Konceptet themelore janë: 1. Hapësira e vektorëve; 2. Transformimet; 3. Ekuacionet diferenciale. Forma e kontrollit të dijeve është në përputhje me procedurat ligjore. Lënda është e pajisur me literaturën e nevojme sipas tematikave. Në gjykimin tonë kjo lëndë jep njohuri të përgjithshme teorike, të cilat për profilin e programin e studimit Master Profesional “Multimedia dhe Television Dixhital” mund të ishin më pak të detajuara dhe më të përmbledhura, duke zvogluar numrin e krediteve dhe orëve mësimore si në auditor ashtu edhe individuale.

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

	<p>2. Teknologjitë e Avancuara në Multimedia - Kategoria B, me 6 ECTS, lëndë e detyrueshme.</p> <p>Sipas syllabusit të lëndës “Avancimet në teknologjitë multimediale dhe interaktive hulumtojnë marrëdhënien midis teknologjisë multimediale dhe përdorshmërisë së aplikacioneve në internet. Kjo seri ka për qëllim të nxjerrë në pah studimet në zhvillim në sistemet interaktive të komunikimit, mjetet, aplikacionet dhe teknikat për të ofruar studiues, praktikantë dhe studentë të teknologjisë së informacionit, shkencës së komunikimit, studimeve mediatike dhe shumë më tepër me një shqyrtim të plotë të këtyre trendeve të teknologjisë multimediale.” Konceptet themelore që jep lënda janë: 1.Grafika Kompjuterike 3D dhe Animim të Avancuar; 2. Dizenjimi i Multimedias dhe Ndërveprimi; 3. Produksioni audio-vizive.</p> <p>Lënda është e kategorisë karakterizuese përgatitje për disiplinën shkencore dhe përmban 15 tema (pa përfshirë provimin përfundimtar dhe zgjidhjen e tezës së provimit). Temat përgjithësisht përshtaten me përdorimin e teknologjive të avancuara për komunikimin në epokën dixhitale. Disa nga temat janë teknikat e animimit të avancuar 3D dhe teknologjitë që përdoren; Teknikat e avancuara të disenjimit grafik fotografisë dhe videos; Teknikat e postproduksionit; Produksioni 3D; Teknologjitë e avancuara 3D, etj.</p> <p>Forma e kontrollit të dijeve është në përputhje me procedurat ligjore. Lënda është e pajisur me literaturën e nevojshme sipas tematikave.</p> <p>3. Laborator për Multimedia - Kategoria B, me 6 ECTS, lëndë e detyrueshme. (Kjo lëndë u zhvillua në semestrin e dytë pasi gjatë semestrit të parë ishte i paplotë laboratori.)</p> <p>Kjo ishte një nga lëndët me detyra praktike dhe profesionale të avancuara që i ndihmon studentët të formojnë njohuritë dhe shprehitë e duhura profesionale. Elementët kryesorë të kësaj lënde janë 1. Laborator për Produksion dhe postproduksion; praktikë me projekte; 2. Laborator për Animim; praktikë me projekte; 3. Laborator për Përpunim Imazhi; praktikë me projekte.</p> <p>Forma e kontrollit të dijeve është në përputhje me procedurat ligjore. Lënda është e pajisur me literaturën e nevojshme për programet / softëare and dhe tematikat përkatëse.</p> <p>4. Seminar në Multimedia - Kategoria B, me 6 ECTS, lëndë e detyrueshme</p> <p>Sipas syllabusit të lëndës “Objektivi kryesor i kursit është të eksplorojë tri shtylla themelore nën Multimedia: Komunikimin, animimin dhe interaktivitetin. Ky kurs mbulon teknikat dhe metodologjitë teorike relevante për teknikat e realizimit të produksioneve multimediale”. Seminari në multimedia bën një ndërthurje të elementëve të kërkimit dhe gjetjes së informacionit dhe veshjes së këtij informacioni me përmbajtjen grafike, duke bashkuar elementët e storytelling me teknologjinë. Lënda jep informacione edhe për mediat sociale duke përdorur teknikat e ndryshme të komunikimit</p> <p>Forma e kontrollit të dijeve është në përputhje me procedurat ligjore. Lënda është e pajisur me literaturën e nevojshme për programet / softëare and dhe tematikat përkatëse.</p> <p>5. Menaxhimi i Projekteve - Kategoria B, me 6 ECTS, lëndë e detyrueshme.</p>
--	---

	<p>Kursi i pajis studentët me njohuri të thelluara për procesin e menaxhimit të projekteve, duke dhënë informacione se çfarë është një projekt dhe cilët janë format e paraqitjes së një projekti. Sipas syllabusit "... ka si synim të japë një tablo të qartë të vendimarrjes në lidhje me projektin, etapat që kalohen për selektimin, aprovimin dhe monitorimin e një projekti." Konceptet kryesore janë: Menaxher Projekti; Lidërsia; Trendet në IT; Cikli jetësor i projekteve; Tipet e organizatave (funksionale, matricë, projekt). Fushat e njohurive të projekteve.</p> <p>Forma e kontrollit të dijeve është në përputhje me procedurat ligjore. Lënda është e pajisur me literaturën e nevojshme për tematikat e saj. Gjatë anketimeve me studentët lënda ishte rankuar me më pak se 50% të vleresimeve positive dhe ky mendim u shfaq edhe gjatë intervistimit me studentët. Për vitin mësimor 2019- 2020 lënda do të jepet ng një petagog tjetër, i brendshëm, me synimin për ta sjellë më afër me tematikat e programit.</p> <p>Semestri II</p> <p>1. Produksioni i Filmit dhe Medias - Kategoria B, me 6 ECTS, lëndë e detyrueshme.</p> <p>Lënda ka si objektivi "... (i) Të kuptuarit e karakteristikave të medias; (ii) Praktikimi i talenteve në manipulimin e pamjes dhe zërit; (iii) Aftësi kritikuese dhe analizuese mbi materialin e prodhuar; (iv) Të kuptuarit e termave kryesore gjatë prodhimit të pamjes dhe zërit; (v) Të mësuarit e teknikave dhe aftësive bazike të ndërtimit të skenarit, kompozimit, ndriçimit, dizenjimit të tingullit, vendosjes së kamerës etj. Ndër konceptet themelore që jep lënda janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Skenar, kompozimi, dizenjimi;</li> <li>▪ Teknika të kamerës dhe ndriçimit;</li> <li>▪ Njohje të pajisjeve;</li> <li>▪ Njohje të metodave të planifikimit dhe procedurave të punës.</li> </ul> <p>Forma e kontrollit të dijeve është në përputhje me procedurat ligjore. Lënda është e pajisur me literaturën e nevojshme për tematikat e saj.</p> <p>2. Efektet Vizuale - Kategoria C, me 6 ECTS, lëndë me zgjedhje.</p> <p>Lënda synon që në fund të kursit "...fund të kursit studentët duhet: (i) Të kenë njohuri për efektet dhe mjetet e AE; (ii) Të importojnë projekte nga programe të tjera si Adobe Premiere apo Photoshop dhe të shtojë efektet e AE; (iii) Të krijojnë projekte të shkurtra artistike me AE.</p> <p>Forma e kontrollit të dijeve është në përputhje me procedurat ligjore. Lënda është e pajisur me literaturën e nevojshme për tematikat e saj.</p> <p>3. Editimi dhe Masterizimi Audio - Kategoria C, me 6 ECTS, lëndë me zgjedhje.</p> <p>Objektivat janë: (i) konvertuesit dhe mjetet e masterizimit; (ii) Stabilizimi i karakteristikave të regjistrimit; (iii) Dinamika audio; (iv) Masterizim</p> <p>Forma e kontrollit të dijeve është në përputhje me procedurat ligjore. Lënda është e pajisur me literaturën e nevojshme për tematikat e saj.</p> <p>4. Kompresimi i Përmbajtjes Multimediale, Sinkronizimi dhe Transferimi - Kategoria c, me 6 ECTS, lëndë me zgjedhje</p> <p>Objektivat janë: (i) Kompresim dhe dekompresim; (ii) Sinkronizim; (iii) Standartizim; (iv) Transferim i përmbajtjes.</p>
--	--

19

	<p>Forma e kontrollit të dijeve është në përputhje me procedurat ligjore. Lënda është e pajisur me literaturën e nevojshme për tematikat e saj.</p> <p>5. Provimi/Projekti përfundimtar - Kategoria E, me 6 ECTS, lëndë e detyrueshme</p> <p>Forma e kontrollit të dijeve është në përputhje me procedurat ligjore. Lënda është e pajisur me literaturën e nevojshme për tematikat e saj.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Veprimtaritë formuese janë të ndara mjaft qartë midis lëndëve të ndryshme. Në semestrin e parë lëndët “Seminar në multimedia” dhe “Laborator në multimedia” janë lëndë kryesisht praktike. Tre lëndët e tjera kanë kryesisht profil teorik. Megjithatë edhe këto lëndë kanë të kombinuar elementë të praktikës për informacionet e dhëna. Semestri i dytë ka një peshë më të madhe të lëndëve praktike. “Produksioni i Filmit dhe Medias”, “Efektet Vizuale”, “Editimi dhe Masterizimi Audio”, “Kompresimi i Përmbajtjes Multimediale, Sinkronizimi dhe Transferimi” janë lëndë thuajse tërësisht praktike. Kjo ndarje e lëndëve mundëson arritjen e objektivave formuese si edhe punësimin e studentëve pas përfundimit të shkollimit.</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>2018-2019 është viti i parë i zbatimit të Masterit Profesional “Multimedia dhe Dixhital” dhe hartimi i programit të lëndëve është bazuar në përvojën më të mirë edhe të universiteteve në kuadër të projektit. Literature është bashkëkohore dhe në një pjesë të madhe të saja sidomos për programet teknike është në gjuhën angleze. Studentët kanë njohuri të mira të gjuhës angleze, për pjesën e programeve/software që përdorin dhe pedagogët e lëndëve japin informacione për pjesët që janë të reja nga software. Nuk ndjehej nevoja për ti përshtatur këto programe në gjuhën shqipe, apo për të përkthyer librat e softëare në gjuhën shqip. Mësimi i gjuhës angleze është përfunduar si cikël në programin bachelor Programi i studimit dhe njohuritë praktike të fituara gjatë tij i japin mundësi studentëve për tu punësuar në sektorin mediatik, në pozicione të ndryshme tekniko realizuese.</p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Duke shqyrtuar programet e studimit, syllabuset e lëndëve për MP “Multimedia dhe Dixhital” shikohet një ndërthurje e lëndëve të nevojshme për formimin profesional të studentëve. Aftësitë dhe kompetencat profesionale krijohen kryesisht nga lëndët e semestrit të dytë, por duke integruar mjaft nga konceptet teorike të nxëna gjatë lëndëve teorike në semestrin e parë Në kuadër të projektit me të cilën është financuar studio e medias janë garantuar edhe ndërthurja e duhur e programit të studimit dhe organizimi i qartë i tij në shërbim të aftësimin të thelluar profesional të studentëve.</p>			
<p><b>Kriteri 8.</b> Organizimi i programit të studimit siguron aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>Edhe gjatë vizitës së GVJ në universitet dhe në takimet me studentët që kanë përfunduar të parët Masterin Profesional “Multimedia dhe Televizion Dixhital” vërehet se një pjesë e madhe e tyre janë të punësuar në media të ndryshme ose në zyrë të marrëdhënieve me publikun. Kjo edhe falë shkollimit, përfundimit të programit Master Profesional.</p> <p>Programi i studimit dhe njohuritë praktike të fituara gjatë tij i japin mundësi studentëve për tu punësuar në sektorin mediatik, në pozicione të ndryshme tekniko realizuese.</p>			
<p><b>Kriteri 9.</b> Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Edhe gjatë vizitës së GVJ në universitet dhe në takimet me studentët që kanë përfunduar të parët Masterin Profesional “Multimedia dhe Televizion Dixhital” vërehet se një pjesë e madhe e tyre janë të punësuar në media të ndryshme ose në zyrë të marrëdhënieve me publikun. Kjo edhe falë shkollimit, përfundimit të programit Master Profesional.</p> <p>Programi i studimit dhe njohuritë praktike të fituara gjatë tij i japin mundësi studentëve për tu punësuar në sektorin mediatik, në pozicione të ndryshme tekniko realizuese.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

**Standardi II.5**

**Personeli akademik dhe ndihmës-akademik, që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional për garantimin e standardeve të mësimdhënies në kuadër të programit të studimit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>			
<b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.	Stafi akademik me kohë të plotë në programin mësimor MP “Multimedia dhe Televizion Dixhital” janë të gjithë me gradën shkencore Doktor i Shkencave. Kjo është në përputhje me standartet ligjore të përcaktuara nga Ministria e Arsimit. Në këtë program studimi, për vitin 2019-2020 nuk ka lektorë me kohë të pjesshmë. Në vitin e parë kishte vetëm një pedagoge për lëndën “Menaxhimi i projekteve” e cila gjithashtu përmbushte kriteret e nevojshme të kualifikimit akademik.			
<b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.	Pedagogët me kohë të plotë në programin mësimor MP “Multimedia dhe Televizion Dixhital” kanë një kualifikim të lartë sidomos në lëndët e teknologjisë së informacionit. Kjo i ndihmon lektorët të japin njohuritë e nevojshme teorike, sidomos gjatë semestrit të parë. Nga cv e pedagogëve kuptohet kualifikimi i vazhdueshëm për subjektet e teknologjisë së informacionit. Pjesët specifike të tematikave të lidhur me teknologjitë e medias janë të reja në tregun shqiptar dhe për rrjedhojë nuk ka pedagogë specifikë për këto tematika, të diplomuar dhe specializuar për mediat e reja. Këto mungesa janë zëvendësuar me lektorë të huaj të ardhur në kuadër të projektit si edhe me lektorë të ftuar nga mediat e reja dhe tradicionale në vend. Këta lektorë të huaj kanë ndihmuar edhe në trajnimin e stafit aktual akademik në kuadër të projektit ERASMUS + DIMTV, me financimin e fondeve të BE.			
<b>Kriteri 3.</b> Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.	UAMD ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione të tjera arsimore në vend si edhe mban kontakte me bizneset në fushat respektive sipas degëve/ programeve të studimit. Edhe në fakultetit e Teknologjisë së Informacionit i kushtohet kujdes organizmit të praktikave profesionale dhe bashkëpunimit me bizneset. Ndërsa për programin MP “Multimedia dhe Televizion Dixhital” megjithëse nuk ka praktikë të specifikuar pranë bizneseve, pasja e studios multimediale është një aset shumë i mirë për të pajisur studentët me njohuritë praktike. Si për studion kompjuterike ashtu edhe për laboratorin e multimedias ka staf akademik ndihmës që i menaxhon dhe kujdeset për mbarëvajtjen e tyre. Sikurse përshkruhet edhe në rregulloret dhe përshkrimet e punës, laborantët mbështesin stafin akademik gjatë orëve të mësimin në laborator. Ata po ashtu mbështesin edhe organizimin e aktiviteteve të ndryshme. Po kështu edhe personeli i lëndeve përkatëse kujdeset dhe drejton punën në këto laboratore për zhvillimin e lëndeve specifike mësimore.			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për udhëzimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.				
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni i arsimit të lartë siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësmësimor-shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Standardi II.6</b>				
<b>Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit dhe realizimin me sukses të tyre.</b>				
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>			
<b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	Master Profesional “Multimedia dhe Dixhital” është ndërtuar falë bashkëpunimit dhe financimit në kuadër të projektit BE “Development and Implementation of Multimedia and Digital TV Curricula (DIMTV)” program “Erasmus +”. NJBTI është në bashkëpunim të vazhdueshëm me universitetet partnere në consorcium për përmirësimin e programit të studimit. Aktivitetet janë si trajnime të kryera nga profesorë të këtyre universiteteve për mësimdhënës ashtu edhe me seminare të vecanta për studentët. Diskutimet në vazhdimësi në kuadër të projektit i shërbejnë përmirësimin të programeve të studimit.			
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime, në kuadër të përmirësimin të programit të studimit, edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen nëse ato janë në funksion të përmirësimin të programit të studimit.	NJBTI harton dhe dy formate të ndryshme pyetësorësh. Njëri nga pyetësorët është në kuadër të projektit dhe financimit të BE dhe tjetri është pyetësori që vetë universiteti realizon, në përfundim të çdo semestri. Nga pyetësori janë marrë informacione për përmirësimin të programit të studimit. Një ndër to ka qenë edhe ndryshimi në lëndën “Menaxhim Projekti” e cila është renditur me notë të ulët nga vlerësimi i studentëve. Në vitin e ri akademik 2019-2020 NJBTI ka vendosur të ndryshojë përbajtjen e kësaj lënde dhe pedagogun drejtues.			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programeve të studimit.	Studentët e vitit akademik 2018-2019 janë studentët e parë që përfundojnë këtë program studimi. Për rrjedhojë kontaktet me fakultetin i kanë të drejtpërdrejta gjatë këtij viti. Një pjesë e madhe e tyre janë të punësuar në biznese mediatike. UAMD dhe fakulteti kanë një zyrë të vecantë për studentët dhe alumni. Aty mbahen informacionet për studentët që përfundojnë programin e studimit dhe punësohen.			
<b>Kriteri 4.</b> Në bashkëpunim me institucionet publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme në përputhje me kërkesa dhe nevoja specifike lokale dhe zhvillimi.	UAMD dhe NJBTI hapi fillimisht programin bachelor në multimedia dhe digital TV. Edhe ky program i cilit të parë u financua nga program TEMPUS RICIDUM i BE-së. Pas një periudhe 6 vjecare të këtij programi studimi të ciklit të parë dhe duke studjuar edhe tregun e punës dhe nevojën për diplomime në ciklin e dytë të studimit, UAMD vendosi të krijojë programin master. Program “Master Profesional “Multimedia dhe Televizion Dixhital” të ofruara janë në përputhje me zhvillimin kombëtar.			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës II</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

22

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<b>Standardi III.1</b>	
<b>Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>IAL ndjek aktualizimin e metodave të mësimdhënies, duke reflektuar një raport të drejtë mes pjesës së trajtimeve teorike me atë praktike, duke stimuluar interaktivitetin në auditor. Gjatë takimit që u zhvillua me drejtues të Dekanatit dhe Departamentit ku përfshihet programi Master Profesional “Multimedia dhe Televizioni Dixhital, u informuam mbi mbikqyrjen nga afër të rezultateve të anketimeve me studentët, të realizuara në fund të dy semestrave, mbi vlerësimet dhe opinionet e tyre mbi procesin studimor, në seancat e leksioneve dhe seminareve, në orët e angazhimit aplikativ në laboratorin multimedial, qendrën e kompjuterave, apo periudhën që kalojnë jashtë mjediseve të UAMD-së. Thuajse të gjithë përfaqësuesit që u takuan me grupin e ekspertëve të jashtëm shprehën mendimin se si një program i ri, nevoja për ndryshime përmirësuese në programin e studimit të ciklit të dytë Master Profesional “Multimedia dhe Televizion Dixhital” mbetet dosmosdoshmëri në vijim.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Grupi i vlerësimit të jashtëm në takimet me studentët, stafin akademik me kohë të plotë, apo me kohë të pjesshme, si dhe me drejtuesit e Departamentit a të Fakultetit ku përfshihet ky programi studimi, diskutoi gjerësisht mbi instrumentet e monitorimit të aftësive mësimdhënëse. Përmes Njësisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë, NJSBC, kryhej ndërtimi i pyetësore që u jepeshin studentëve, pyetësorë që kërkonin përgjigje mbi lektorët e lëndëve, mbi kurrikulën, si dhe në lidhje me shërbimet që iu ofroheshin atyre nga institucioni. Përgjigjet e pyetësorit që iu shpërndahet në fund të secilit semestër tek studentët për t’u plotësuar (dy herë brenda vitit akademik), iu është dërguar elektronikisht dhe në mënyrë të personalizuar të gjithë stafit akademik të përfshirë. IAL-ja bën publike rezultatet dhe analizat e rezultateve të vlerësimit të programeve të studimit, duke respektuar etikën akademike dhe privatësinë e palëve të përfshira. Në mënyrë piramidale me gjetjet e vlerësimit njiheshin, pedagogët, departamenti, dekanati dhe senati akademik në UAMD.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Në takimin që zhvilluam me studentët e programit që është në fokus, (në të dy vitet akademike, 2018-2019 dhe 2019-2020), ata konfirmuan zhvillimin e metodës së anketimit të tyre mbi aspektet e mësimdhënies, përmes plotësimin të pyetësorëve. Pyetësorët shpërndahen në fund të dy semestrave që ka viti akademik. Studentët që kanë kryer Masterin Profesional në programin që është në fokus të këtij vlerësimi e përshkruan pyetësorin si optimal në kërkesat për informacion që ju drejtoheshin atyre, si dhe të kuptueshëm në përmbajtje. Duke qënë një program i ri studimi, studentët shpresojnë se propozimet dhe vërejtjet e tyre do të konsideroheshin nga Departamenti, Fakulteti apo senati akademik në UAMD.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Gjetjet e pyetësorit bëhen publike, si e përmendëm më sipër, duke respektuar etikën akademike dhe privatësinë e palëve të përfshira. Në mënyrë piramidale me gjetjet e vlerësimit njiheshin, pedagogët, Departamenti, dekanati i Fakultetit dhe strukturat drejtuese në UAMD. Në rastet kur</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

23

	evidentoheshin mangësi dhe dobësi, rezultatet e vlerësimit shoqërohen me plan masash për përmirësimin a tejkalimin e tyre. Në rastet kur hasen rezultate nën nivelin mesatar për lektorë të jashtëm, kontrata në vitin pasardhës nuk rinovohet.								
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Procesi i vlerësimit të mësimdhënies, përmes mekanizimit të pyetësorëve, ose nga monitorimet që realizonte NJSBC, a Departamenti ku përfshihet programi që kemi në fokus – këto shërbejnë për promovimin e rasteve pozitive, në mënyrë që të evidentoheshin si modele për përmirësimin e performancës në seancat e trajtimeve teorike ose ato praktike në laboratorin multimedial. Kjo vlen për ecurinë e qëndrueshme të këtij programi që është një aplikim në vitin e dytë akademik, me plot sfida dhe ambicie për të ardhmen.								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<b>Standardi III.2</b>	
<b>Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikatat më të mira.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë: leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikatat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Bazuar në Statutin e UAMD dhe rregullores së miratuar nga ky IAL, format e mësimdhënies janë përmes leksioneve, seminareve, të ndërthurura si leksione dhe seminare, module, si dhe trajnim profesional kur studentët atashohen jashtë universitetit. Nga biseda me studentët, u informuam dhe për zhvillimin e orëve të hapura, me të ftuar ekspertë të fushës, që kanë ardhur në laboratorin multimedial apo qendrën e kompjuterave për prezantimin e shprehive profesionale, përdorimin e aplikacioneve, si dhe trajtimin teorik të temave që lidhen me dinamikën e zhvillimit të multimedias dhe televizionit dixhital.
<b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.	Nga bashkëbisedimi me studentët e vitit të kaluar akademik (2018 – 2019), ata propozuan më shumë kohë të shpenzohej në laboratorin multimedial dhe të ftoheshin më shumë ekspertë profesionistë të multimedias dhe televizionit dixhital. Kjo problematikë me studentët e gjeneratës së parë të programit kishte ndodhur nga shkak i vonësive në ngritjen e laboratorit multimedial dhe sallës së kompjuterave. Por nga programi i këtij viti akademik vijues (2019-2020) u evidentua një raport më i drejtë i trajtimeve teorike me angazhimin praktik të studentëve të këtij programi, si pasojë e infrastrukturës në dispozicion të studentëve. Nga stafi akademik dhe drejtuesi i Departamentit u pranua angazhimi për pjesën bibliografike, duke përfshirë dhe tekste ose materiale të përkthyer ose të përshtatura, proces që kërkonte kohën e vet për t'u përmbushur.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni duhet të mundësojë përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të	Përfundimi i laboratorit multimedial, si dhe qendrës së kompjuterave kanë lehtësuar vijueshmërinë e zhvillimit të programit për këtë vit akademik, duke rritur ndjeshëm efektivitetin e zhvillimit të pjesëve teorike dhe praktike të lëndëve, duke gjallëruar interaktivitetin në orën e mësimin, si dhe në diskutimin dhe analizimin e detyrave konkrete që realizohen nga studentët. Ata kanë mundësi të fitojnë njohuri dhe shprehje aplikative nga drejtuesit e lëndëve, duke punuar individualisht ose në grup për konkretizimin e tyre. Gjatë vizitës në institucion grupi i vlerësimit të jashtëm pati mundësi të ndjekë procesin e kryer nga vetë studentët nën

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.	kujdesin e drejtuesit të lëndës, si dhe u ndoqën formatet e komunikimit mes stafit akademik gjatë zhvillimit të programit – proces që mbante të përfshirë studentët e këtij program studimi.			
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.	Në programin e studimit Master Profesional “Multimedia dhe Televizion Dixhital” janë të angazhuar pedagogë me experiencë të gjatë mësimdhënie në Departamentin e Teknologjisë së Informacionit. Angazhimi i tyre në këtë program sapo ka nisur (ata kanë përfunduar një vit akademik) dhe gjatë takimit që zhvilluan me ta u identifikua gatishmëria për vijimin e përmirësimeve dhe të përshtatjes së lëndëve, duke u bazuar dhe në mendimet e sugjerimet që kanë bërë studentët e sapo diplomuar, por dhe duke bashkëpunuar me partnerët e huaj që mbështesin Programin Master në Multimedia dhe Televizion Dixhital, nga Estonia, Çekia dhe Sllovenia.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Nga takimi me studentët dhe anëtarët e stafit akademik u evidentua fakti që pedagogët e lëndëve aplikojnë forma të larmishme në zhvillimin e orës së mësimi. Megjithatë programi është në hapat e para dhe Departamenti përgjegjës ka analizuar ecurinë e vitit akademik 2018-2019, ku ka evidentuar nevojën për ndërhyrje përmirësuese në format e mësimdhënies, si reflektim dhe i mendimeve e sugjerimeve nga studentët. Për vetë natyrën që ka program, fluksi i prezantimeve në auditor realizohet me forma të larmishme, si video demonstrim, animim etj.			
<b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimi.	Nga opinionet e shprehura ng studentët në takimin e zhvilluar nga grupi i vlerësimit të jashtëm u përmend aplikimi nga pedagogët e lëndës të formave tërheqëse në shpjegimet dhe parashtrimet e tyre, qoftë në seancat e leksioneve ashtu dhe në seminare.			
<b>Kriteri 7.</b> Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë te studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënies të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Në kurrikulën e programit që është në fokus harmonizohet drejt pjesa e punës së tyre në grup, si dhe angazhimi për detyra individuale, sidomos ato që lidhen me postproduksionin në materialet audiovizive, video, animim etj.			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi III.3

**Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Procesi mësimor e shkencor, realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	Grupi i vlerësimit të jashtëm gjatë vizitës në institucion monitoroi dhe mjediset ku zhvillohej procesi mësimor, si dhe mjediset e përbashkëta të studentëve. Ky aspekt u diskutua dhe në takimin me studentët e programit që është në fokus, si dhe me stafin akademik. Për vetë numrin e tyre, si dhe nevojat që kanë për realizimin e programit njëvjeçar, hapësirat ishin funksionale, të mjaftueshme dhe që mirëmbaheshin nga personalitë ndihmës dhe nga vetë studentët. Ky element është ndihmë në realizimin me sukses të aktivitetit mësimor dhe shkencor në programin e ciklit të dytë të studimit Master Profesional “Multimedia dhe Televizioni Dixhital”.

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

25

<b>Kriteri 2.</b> Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor dhe praktikave.	Laboratori multimedial dhe qendra (salla) e kompjuterave kanë hapësirë të mjaftueshme për zhvillimin e procesit mësimor dhe realizimin e detyrave dhe punimeve të ndryshme nga studentët. Funksionaliteti në këto mjedise ju lehtëson punë, për të shfrytëzuar kohën dhe për produkte cilësore. Kjo u pohua dhe nga studentët e këtij programi master profesional në takimin me ta.
<b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor.	Rrjeti kompjuterik, si dhe programet e instaluar në to krijojnë një atmosferë interaktive dhe ndjekje në kohë reale të të gjitha fazave të zhvillimit të detyrave dhe punimeve nga studentët. Për rrjetin kompjuterik në mënyrë sistematike realizohet servisi, duke i mbajtur të gjitha device-t dhe aksesoret përbërës në gjendje pune.
<b>Kriteri 4.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Thuajse e gjithë literatura që ofrohet në lëndët e specialitetit për këtë program janë në gjuhën angleze. Nga Departamenti po shikohet mundësia dhe përshtatja e literaturës dhe në shqip. Kjo si pasojë dhe e propozimeve që kanë bërë studentët e gjeneratës së parë të këtij programi (ata që studjuan në vitin akademik 2018 – 2019).
<b>Kriteri 5.</b> Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.	Studentët dhe pedagogët e programit që është në fokus më shumë shfrytëzojnë bibliotekën që është në mjediset e godinës A të UAMD, pasi aty zhvillojnë dhe procesin mësimor. Institucioni ka dhe një bibliotekë të dytë në Godinën B, ndërtuar vitet e fundit në periferi të territorit të Bashkisë së Durrësit. Nga fusha e medias dhe multimedias kishte botime të fundit, por që ishin në pak kopje, për shkak të kostove të larta. Punonjësit na treguan kushtet për frekuentuesit e bibliotekës, aksesin për të ndjekur virtualisht materiale që ju nevojiten për procesin mësimor dhe shkencor, sipas titujve apo autorëve. Jo të gjitha kompjuterat në sallën e bibliotekës ishin në gjendje pune, në momentin e vizitës së grupit të vlerësuesve të jashtëm, por kërkimi për literaturën kompesohej nga përdorimi i aparatëve celularë të zgjuar, në kushtet kur në mjedise ishte siguruar wi-fi.
<b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.	Bazuar në një mbështetje që UAMD ka marrë nga Federata Ndërkombëtare e Shoqatave dhe Institucioneve Bibliotekare, IFLA, prej 5 viteve është instaluar një program integruar bibliotekar me katalog të një fondi të hapur materialesh virtuale, një depozitë literature në dispozicion dhe të studentëve e pedagogëve të këtij programi të ciklit të dytë të studimit.
<b>Kriteri 7.</b> Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	Mjediset ku zhvillohet leksionet dhe seminarët, si dhe pjesa aplikative janë në dispozicion të studentëve jo vetëm në orarin e përcaktuar për programin, por ata kanë akses për të studjuar dhe ushtruar dhe në hapësira të tjera kohore, sipas nevojave. Kjo ju jep mundësi që ata ta kenë infrastrukturën në dispozicion për detyrimet që kanë në lëndë të ndryshme dhe për angazhimin me punimin e diplomës. Aksesin dhe efektivitetin e infrastrukturrës laboratorike studentët e evidentuan dhe gjatë bashkëbisedimit që zhvilloi me ta grupi i vlerësimit të jashtëm.
<b>Kriteri 8.</b> Në funksion të mësimdhënies, personelin akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	Për vetë natyrën e këtij program Master Profesional, komunikimi virtual pedagog – studentë ndihmon në procesin e prezantimeve dhe të realizimit të detyrave, për këto të fundit asistencë e pedagogut vijon në secilën fazë dhe ai ka mundësi të monitorojë ecurinë e studentit, duke bërë ndërhyrje për rastet kur janë të nevojshme sqarimet dhe plotësimet orientuese. Google Classroom është konsideruar si efikas në komunikimin mes studentëve dhe drejtuesve të lëndës.
<b>Kriteri 9.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e	Përmes sistemit online AULA studentët marrin informacion të personalizuar për rezultatet e provimeve, regjistrimin e lëndëve, apo orarin për mësimin,

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

26

komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.	ndërkohë që duke përdorur platformën G-suite të Google, aksesohet email-i i secilit student me domain-in @uamd.edu.al		
<b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asistion dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	Në vitin e parë, të funksionimit të programit (viti akademik 2018 – 2019), studentët, tashmë të diplomuar, nuk realizuan në fund të studimeve temë diplome, por kanë dhënë provim përfundimtar. Sikundër dhe e kemi përmendur më sipër, kjo për shkak se nuk ishin gati për ta dy hapësirat e domosdoshme, laboratorit multimedial dhe qendra e kompjuterave. Por për vitin akademik në vijim Departamenti raportoi për grupin e vlerësimit të jashtëm se do të ndiqet procedimi me përgatitje të temës së diplomës dhe për këtë janë marrë masa për orientimin e tyre në përzgjedhjen e temës, si dhe më pas me asistimin në séance metodologjike për konceptimin dhe përgatitjen e tyre. Në semestrin e dytë do të ketë dhe më shumë kohë në dipozicion, si ndihmë për studentët në kryerjen e këtij objekti të rëndësishëm në finalizim të studimeve njëvjeçare.		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>
			<b>X</b>

<b>Standardi III.4</b>	
<b>Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë, aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.	Në UAMD ka një strukturim kapilar të promovimit të përmirësimit të vazhdueshëm të mësimdhënies, si një investim në sigurimin e brendshëm të cilësisë, si Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Drejtoria e Kurikulave, Dega Mësimore, Drejtoria e Shërbimeve Akademike, të cilat janë njësi që ndjekin garantimin e cilësisë në programet e studimit, që bashkërendojnë angazhimin e tyre me njësinë bazë. Vetë NJSBC është e strukturuar në nivel drejtorie dhe ajo monitoron e vlerëson procedurat dhe standardet e fakulteteve dhe hallkave të tjera të institucionit, duke analizuar dhe krahasuar rezultatet në bazë të treguesve të cilësisë, mbështetur në kriteret dhe standardet e përcaktuara në Kodin e Cilësisë, dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore.
<b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.	Departamenti i Teknologjisë së Informacionit, ku përfshihet programi Master Profesional që është në fokus, ndjek nga afër cilësinë e mësimdhënies, kjo dhe për faktin se “Multimedia dhe Televizioni Dixhital” është provuar vetëm në një vit të plotë akademik (2018 – 2019) dhe aktualisht ky është viti i dytë. Në takimin që u zhvillua me anëtarët e stafit me kohë të plotë dhe të pjesshme, si dhe drejtuesit e Departamentit dhe Dekanatit u pohua nevoja e monitorimit nga afër, për të evidentuar aspekte që kërkojnë përmirësim, qofshin në lëndët me natyrë teorike, ashtu dhe ato me shprehje praktike, në favor të rritjes së cilësisë së njohurive, si dhe metodave të larmishme të prezantimeve, ilustrime dhe praktikave të ndryshme.
<b>Kriteri 3.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.	Funksionaliteti i dy mjediseve kryesore ku zhvillon pjesën më të madhe të procesit studimor programi Master Profesional “Multimedia dhe Televizioni Dixhital”- laboratorit i multimedias dhe qendra e kompjuterave – janë elementë stimulimi për forma të larmishme të mësimdhënies dhe

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

	realizimit të detyrave dhe punimeve, si dhe për aplikimin e inovacioneve si rezultat i përdorimit të programeve të aktualizuara në rrjetin e komunikimit, si dhe në set-in e pajisjeve të prodhimit dhe postproduksionit audio dhe audioviziv, në formatin video, animim etj.			
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Personeli akademik me kohë të plotë ndjek grafikët e planifikuar nga njësia bazë për kontributin kërkimor dhe shkencor, në pjesmarrjen në konferenca apo realizimin e punimeve shkencore. Kjo vlen dhe për personelin mbështetës të angazhuar në programin që është në fokus. Kjo ndihmon në rritjen e standardit të mësimdhënies nga ana e trupës pedagogjike, nxitjen e tyre për të aktualizuar dhe pasuruar njohuritë që japin për studentët.			
<b>Kriteri 5.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Drejtoria e Kurikulave, Dega Mësimore, Drejtoria e Shërbimeve Akademike, si dhe Departamenti ku përfshihet programi Master Profesional investohen për angazhimin me trajnime e kualifikime të personalit akademik, për t'ju përgjigjur kërkesave të kohës në konceptimin e kurrikulës dhe zhvillimin e orës së mësimi, më synimin për ta bërë sa më tërheqëse për studentët.			
<b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.	Në takimin që u zhvillua me personelin akademik si dhe nga dokumentacioni që u shqyrtua në sektorin e burimeve njerëzore, u evidentua përpjekja e pedagogëve për t'u përfshirë në aktivitet kërkimor dhe shkencor, në ndjekjen e eventeve shkencore brenda ose jashtë vendit, potencial që jep efekte në rritjen e cilësisë së zhvillimit të lëndës dhe implementimit të metodave të reja.			
<b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	Siç e përmend më sipër, personeli akademik ndjek grafikët e planifikuar nga njësia bazë për kontributin kërkimor dhe shkencor, në pjesmarrjen në konferenca apo realizimin e punimeve shkencore. Kjo vlen dhe për personelin mbështetës të angazhuar në programin që është në fokus. Efekti i këtyre investimeve shkon në favor të rritjes së standardit të mësimdhënies nga ana e trupës pedagogjike, nxitjen e tyre për të aktualizuar dhe pasuruar njohuritë që japin për studentët.			
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.	Duke qenë se ky program Masteri Profesional ka tre partnerë ndërkombëtarë (nga Estonia, Çekia dhe Sllovenia) kjo ka përfshirë dhe personelin akademik të tyre që të jenë në auditorët e UAMD, në programin që është në fokus, si një shkëmbim përvojash, idesh dhe metodologjish në mbarëvajtjen e procesit studimor, duke injektuar njohuri bashkëkohore, si përmirësim cilësor. Nga kjo përfitojnë pedagogët që janë pjesë e programit Master Profesional "Multimedia dhe Televizioni Dixhital", në ngritjen e tyre profesionale, por mbi të gjitha përfitojnë studentët që frekuentojnë këtë program studimi.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.5</b>	
<b>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme,	Procesi i testimit dhe vlerësimit të studentëve në programin që është në fokus u diskutua me vetë studentët dhe stafin akademik, sikundër u shqyrtuan dhe aktet rregulluese të miratuara. Në statutin dhe rregulloren e UAMD kishte

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

bëhen publike dhe njihen nga studentët.	përcaktime mbi këtë aspekt, për të cilat ishin të informuar dhe studentët. Kjo u pohua gjatë bisedës që u zhvillua me ta, duke konfirmuar informacionin që kishin marrë nga Departamenti, si dhe pedagogët e lëndëve. Këto ishin dhe të afishuara për ta, në kuadër të njohjes me syllabuset e secilës lëndë, të cilat shpërndaheshin në fillim të semestrit elektronikisht por dhe diskutoheshin në takimim e drejtpërdrejtë mes studentëve dhe pedagogut të lëndës.								
<b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Studentët e programit Master Profesional “Multimedia dhe Televizioni Dixhital” treguan për grupin e vlerësimit të jashtëm se që në fillim të vitit akademik ishin njohur me mënyrat e testimit dhe vlerësimit në to, si dhe për pjesën e vlerësimit të punimeve që realizonin – këto ishin të përfshira dhe në përmbajtjet e syllabuseve që kishin shpërndarë pedagogët. - Grupi i vlerësimit u njoh dhe me raste të syllabuseve të cilat orientonin studentin me info bazike mbi etapat e zhvillimit të lëndës, si dhe mënyrën e testimit dhe vlerësimit të tyre.								
<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Siç dhe është shpjeguar më sipër, studentët e gjeneratës së parë të këtij programi studimi, (viti akademik 2018 – 2019) nuk arritën të realizonin punime diplome, por provim përfundimtar. Kjo si pasojë e vonesave në ngritjen e laboratorit multimedial si dhe qendrës së kompjuterave. Pra, atyre nuk ju afrua vlerësimi i njohurive sikundër iu ishte premtuar në fillim të vitit akademik. Kurse për studentët e gjeneratës aktuale (viti akademik 2019 – 2020), sipas pohimeve nga drejtuesi i Departamentit, do të aplikohet punimi i diplomës.								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

<b>Standardi III.6</b>	
<b>Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.	Duke u njohur me syllabuset e lëndës, studenti ka mundësi që në fillim të semestrit ose të zhvillimit të një cikli të njihet me mënyrat dhe metodologjinë e vlerësimit të dijeve që do të zhvillohen. Në syllabus-in e lëndës prezaantohet kuota për provimin (testin) e ndërmjetëm, kuota e pikëve për kryerjen, si dhe për aktivizimin dhe pjesëmarrjen gjatë kohës kur zhvillohet lënda. Të gjitha këto kuota bëjnë në total notën përfundimtare.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Përmes sistemit AULA secili student merr virtualisht përgjigje për rezultatin e tij të provimit. Po virtualisht ata mund të shikojnë përmbajtjen e tezës së tyre, si një mënyrë vetverifikuese për përgjigjet që kanë dhënë në provim.
<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi përfundimtar i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	Provimi në fund të semestrit realizohet faktikisht nga pedagogu i lëndës, kurse vetëm në rastet e riprovimeve kishte dhe pedagogë të tjerë në komisionin vlerësues.
<b>Kriteri 4.</b> Testimi i vlerësimit të njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të	Nuk u evidentuan zhvillime të kontrolleve të njohurive me shkrim me anonimat, ose përmes sekretimit me bar kod të fletëve të tezave, por nga pedagogët e lëndës tregohej kujdesi për të evituar raste të kopjimit gjatë zhvillimit të testeve të ndryshme.

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

monitoruar me personel dhe mjete survejimi.									
<b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënësve për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Procesi i interaktivitetit pedagog – studentë aplikohet dhe në aspektin e vlerësimit për të evidentuar ato pjesë të njohurive për të cilat studenti duhet të fokusohet dhe thellohet më shumë.								
<b>Kriteri 6.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Nga personeli akademik në vitin e kaluar (2018-2019) nuk kishte pasur probleme me plagjiaturën në punimet e diplomës, pasi ato për shkaqet e shpjeguara më lart nuk ishin realizuar. Por kujdes është bërë për evitimin e kopjimit në provime apo në realizimin e detyrave të kursit. Për vetë natyrën që ka programi i studimit që është në fokus, studentët janë koshientë të aplikimit nga pedagogët të programeve hulumtuese për rastet e plagjiaturave të ndryshme.								
<b>Kriteri 7.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Nga takimi me studentët e vitit akademik 2018 – 2019 u pohua se rezultatet që kishin marrë në testime e detyra të kontrollit të dijeve kishin qenë të argumentuara. Ata i kishin marrë në kohë rezultatet, kjo dhe për faktin se programi kishte numër të limituar studentësh që e kanë ndjekur.								
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Studentëve ju bëhet me dije një procedurë standarde për rastet kur ata njihen me vlerësimin dhe duan që ta rishikojnë bashkë me pedagogun e lëndës testimin e tyre, për rastet kur kjo kërkesë refuzohet (tregohen arësyet e refuzimit), apo kur merret parasysh, duke vijuar me rivlerësimin dhe me mbajtjen e një procesverbali mbi gjetjet dhe përputhshmërinë ose jo me vlerësimin fillestar.								
<b>Kriteri 9.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.	Gjatë vitit të parë të funksionimit të programit Master Profesional që është në fokus, nuk ishte regjistruar ndonjë kërkesë ankese nga vlerësimet në ndonjë lëndë. Por në Departament na pohuan se për raste që do të paraqiteshin do të zbatohet një procedurë standarde, bazuar në rregulloren e miratuar të Njësia Kryesore e Teknologjisë së Informacionit.								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

### Standardi III.7

**Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Programi i studimit Master Profesional “Multimedia dhe Televizioni Dixhital” e ka ndërtuar kurrikulën për të tre profilet në një menyrë të tillë që në semestrin e parë studenti të marrë kryesisht një shtresë njohurish të domosdoshme dhe të thelluara teorike dhe në semestrin e dytë vijohet më shumë me lëndë që kanë në thelb shprehite praktike dhe aplikative, për aftësimin e tij profesional, duke përfshirë dhe detyra/produkte konkrete të realizuara prej tij.
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së	Ky program studimi me 60 kredite ju jep studentëve njohuri teorike dhe shprehite praktike për multimedian, bazuar në profilet e tij, i orienton studentët për aftësi profesionale në produksion dhe postproduksion, përpunim imazhi

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

30

informacionit, humane, sociale, të komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	dhe animim 3D. Në përfundim të programit ata janë të gatshëm për të punuar në redaksitë mediatike audiovizive, portalet online, në njësi promovionale dhe PR etj., duke qenë të gatshëm të menaxhojnë detyra dhe objektiva personale dhe në staf, ose për të prodhuar vetë përmbajtje të ndryshme që transmetohen ose publikohen. Pjesa më e madhe e programit të lëndëve dhe aplikacionet që përdorin gjatë vitit akademik është në anglisht, një mundësi kjo dhe e përvetësimit të kësaj gjuhe dhe përshtatjes dhe me ofertën që mund të kenë jashtë vendit.
<b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.	Në pyetësorët që plotëson një student dy herë në vit, në përfundim të secilit semester, ai shprehet dhe për mendimet, sugjerimet a kritikata që ka për zhvillimin e programit mësimor, material që vlen për anëtarët e stafit, Departamentin, Dekanatin, por dhe nivelin drejtues të UAMD, për vlerësim dhe reflektim ndaj ndërhyrjeve të mundshme përmirësuese në kurrikul. Kjo vlen dhe për reflektimin e ndryshimeve në hartimin e syllabuseve në vitin pasardhës nga secili prej pedagogëve.
<b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.	Për testin final pedagogët e lëndëve zhvillojnë seancë rikapitulumit të aspekteve kryesore të lëndës, duke orientuar studentët në tematikat kryesore si dhe duke kujtuar referencat në literaturë, por dhe metodologjinë vlerësuese. Kjo ndiqet dhe në formulimin e tezës, ku qartësisht studentë njëjeh me propocionalitetin e vlerësimit për secilën pyetje/çështje përbërëse të saj. Gjatë bisedës me studentët e gjeneratës së parë (viti akademik 2018 – 2019), ata e evidentuan këtë praktikë të zbatuar gjatë dy semestreve.
<b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	Në procesin e ndryshimit të shpejtë të teknologjisë dhe përhapjes në shkallë të gjerë të internetit – të cilat kanë ndikuar dhe ndikojnë në performancën e medias – kjo mbetet një shtysë për aktualizimin e leksioneve si dhe përshtatjen e seminareve të lëndëve, por dhe duke ftuar në auditor ekspertë të fushës së multimedias në përshtatjen dhe thellimin e njohurive të nevojshme.
<b>Kriteri 6.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.	Duke pasur në dispozicion qendrën e kompjuterave, si dhe laboratorin multimedial realizohet në këtë program studimi harmonizimi i njohurive teorike me shprehite praktike profesionale, si një ndihmë e drejtpërdrejtë në aftësimin e studentëve për të qenë të gatshëm të kontribuojnë në vendet e tyre të punës (për ata që nuk janë të punësuar), ose për të përmirësuar performancën (për ata që janë të punësuar në profil të njejtë me programin e studimit).
<b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.	U evidentua gjatë takimit që u zhvillua me studentët por dhe gjatë takimit me stafin akademik për mbështjen e debatit dhe komunikimit në ekip, për tejkalimin e problematikave të hasuara, ose aspekte të diskutueshme nga pjesa e kurrikulës në këtë program studimi Master Profesional.
<b>Kriteri 8.</b> Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.	Programi është në hapat e para të zbatimit të tij dhe ende nuk mund të thuhet për mbështetje konkrete financiare nga ana e personelit akademik për studentët, në drejtim të realizimit të studimeve të avancuara kërkimore dhe shkencore prej tyre. Në takimin me drejtues të Fakultetit dhe Departamentit ku përfshihet ky program studimi u shpreh angazhimi për në vijim për të mbështetur ide novative a studimeve të avancuara.
<b>Kriteri 9.</b> Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Shpjeguar në pikën e mësipërme.
<b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të	Për vetë karakteristikat e këtij programi Master Profesional, që është një joint venture mes UAMD dhe partnerëve estonezë, çekë dhe sllovenë, atëherë studentët kanë përfutur dhe nga prezanca konkrete e përfaqësuesve të tyre me

mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	cikle leksionesh dhe aplikimesh, që kanë rritur mobilitetin e tyre, por në të njëjtën kohë dhe të pedagogëve që janë përfshirë në program.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi III.8

#### Institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
<b>Kriteri 1.</b> Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfitim të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Programi i studimit Master Profesional “Multimedia dhe Televizioni Dixhital” nuk përfshin në planin mësimor praktikë profesionale, por ato studentët i kryejnë në institucione të tjera, bazuar në marrëveshjet dypalëshe që UAMD ka me to, si mund të përmendet Transmetuesi Publik, RTSH, dhe UBT dhe UP. Në Departamentin përgjegjës na informuan për një proces vijues të marrëveshjeve të tjera me njësi mediatike dhe institucione. Por ky është një element me shumë rëndësi, ndaj kërkon zgjidhje të shpejtë. Dy hapësirat e modernizuara që ka në dispozicion programi i studimit, laboratorit multimedial dhe qendra e kompjuterave nuk mund të zëvendësojnë realizimin e praktikave profesionale brenda ose jashtë territorit të UAMD-së.			
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitim sa më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	Duke qenë se RTSH tashmë është një platformë dixhitale tokësore me 12 kanale të vetat, Departamenti e shikon si një mundësi të mirë përfshirjen e studentëve në praktika profesionale aty. Por kjo nuk mjafton dhe duhen siguruar, siç e përmendëm në pikën më sipër, vende të tjera potenciale ku ata të realizojnë në kushte të përshtatshme praktika profesionale, në kushte optimale për të përfituar njohuri.			
<b>Kriteri 3.</b> Praktikave profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Aktualisht praktika profesionale në këtë program studimi të ciklit të dytë nuk është e përfshirë si lëndë më vete dhe nuk ekuivalentohet me kredite.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

### Standardi III.9

#### Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose	Studentët e gjeneratës së parë të programit të studimit Master Profesional “Multimedia dhe Televizioni Dixhital” (2018 – 2019) janë njohur me

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

32



mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	procedurat e provimit përfundimtar në dy momente, Në seancat orientuese dhe familjarizuese në javën e parë të fillimit të vitit akademik. Kurse informacionin e dytë e kanë marrë në fillim të semestrit të dytë, për kushtet që duhet për t'u futur në provim (nevoja e shlyerjes së detyrimeve), mënyra e strukturimit të tezës, përbërja e komisionit etj.			
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Para dhënies së provimit final ka pasur seanca orientuese dhe konsultuese për natyrën e provimit, strukturimin e tezës me aspekte kryesore nga lëndët e zhvilluara në dy semestrat e vitit akademik.			
<b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Provimi përfundimtar për studentët e këtij programi u bazua në një përmbledhje proporcionale të lëndëve që ishin zhvilluar në dy semestret e vitit akademik 2018 – 2019, përfshiheshin pyetje/aspekte kryesore prej tyre.			
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të studimit/diplomave.	Nuk ka pasur rast të konceptimit apo realizimit të punimeve të diplomës për studentët e gjeneratës së parë në programin e studimit Master Profesional “Multimedia dhe Televizioni Dixhital”.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Nuk ka pasur rast të konceptimit apo realizimit të punimeve të diplomës për studentët e gjeneratës së parë në programin e studimit Master Profesional “Multimedia dhe Televizioni Dixhital”.			
<b>Kriteri 6.</b> Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Për të diplomuarit e vitit akademik 2018 – 2019 nuk u aplikua punimi i diplomës për asnjë prej studentëve, ndaj dhe nuk janë angazhuar pedagogë si udhëheqës diplome ose komision vlerësimi.			
<b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Për gjeneratën e parë të studentëve, të gjithë ata që kishin shlyer detyrimet e kurrikulës u aplikua provim përfundimtar, e sqaruar arsyeja më sipër. Për të gjithë ata që dhanë provimin vlerësimi është bërë me note.			
<b>Kriteri 8.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit për ata studentë të gjeneratës së parë (2018 – 2019), të cilët tashmë janë të diplomuar, (që kishin përfunduar të gjitha detyrimet në finalizimin e kurrikulës), ishin të pajisur me diplomën dhe suplementin e saj, sipas standardit të miratuar nga Ministria e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë.			
<b>Kriteri 9.</b> Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Si dhe në programet e tjera të studimit, edhe në programin që është në fokus diploma për studentët ofrohet në shqip dhe anglisht, me vlerësim sipas formatit evropian ECTS dhe sipas formatit amerikan USCr, si një lehtësi për ata që dëshirojnë të vazhdojnë procesin studimor në vende të tjera.			
<b>Kriteri 10.</b> Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentët nëse kërkohen.	Duke qenë një program i ri studimi, i gjithë dokumentacioni për punimet, detyrat dhe testimet është i ruajtur në Departament, ku na informuan se kjo do të vijonte dhe vitet e ardhshme. Kurse për dokumentacionin e studentëve në sekretarinë mësimore depozitimi dhe ruajtja e tyre është e standardizuar, sikundër dhe për programe të tjera të studimit në fakultetin e Teknologjisë së Informacionit, dhe njësisve të tjera në rang UAMD-je.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

33

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës III	Niveli i përbushjes	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				x




**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA,  
LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

<b>Standardi IV.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni i arsimit të lartë mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Gjatë vizitës në Zyrën e Burimeve Njerëzore të UAMD-së shqyrtuam procedimin me dokumentacionin e personelit që përfshihet në këtë program studimi, Master Profesional “Multimedia dhe Televizioni Dixhital” ku u evidentua dosja përkatëse për personelin akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme që ishte angazhuar në vitin e kaluar akademik (2018 – 2019), si dhe për këtë vit vijues. U shikuan dosje të veçanta për dokumentacionin që përfshihej, gjithashtu shqyrtim u bë dhe për pjesën e personelit ndihmës, qoftë mësimor, qoftë për ata në administratë.</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit. Procedimin për rekrutimin e personelit akademik grupi i vlerësimit të jashtëm e lidhi me përmbajtjen e dosjes personale për secilin nga pedagogët që ishin përfshirë në programin e studimit që është në fokus. U shikuan me zgjedhje rastësore disa dosje, të cilat përmbanin: formularin e aplikimit standard për personel akademik, bashkangjitur dhe CV; tri letra rekomandimi nga pedagogë ose udhëheqës shkencorë; fotokopje e diplomës e noterizuar shoqëruar me listën e notave, dhe kjo e noterizuar; kopje e dëshmimeve të ndryshme të kualifikimeve; fotokopje e dëshmisë për fitimin e gradës Doktor i Shkencave; fotokopje të artikujve shkencorë të publikuar; kopje e ID; urdhëri zyrtar për emërim; kontrata.</p>
<p><b>Kriteri 3</b> Institucioni i arsimit të lartë harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bënë ato publike.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional “Multimedia dhe Televizioni Dixhital” ka vetëm një vit të plotë akademik që funksion, si dhe këtë vit vijues, por është e evidente se nga Departamenti përgjegjës janë hartuar procedura dhe kritere për rekrutimin e personelit që angazhohet, bazuar këto dhe në vendimet e fakultetit apo të IAL-së. Megjithatë numri i studentëve në këtë program është i limituar, për rrjedhojë dhe personeli akademik me kohë të plotë a me kohë të pjesshme është në numër të pakët, do të duhet që kriteret e standardizuara për rekrutim të jenë pjesë e përmbajtjeve që afishohen në webiste-n e institucionit apo të gjenden forma të tjera prezantuese.</p>
<p><b>Kriteri 4</b> Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me</p>	<p>Nga takimi me drejtuesit e Fakultetit dhe Departamentit ku është atashuar programi që është në fokus, si dhe me përfaqësues të personelit akademik u shprehën mendime se procedurat e rekrutimit dhe metodologjia e vlerësimit të kandidatave të interesuara do të vijojnë të specifikohen më shumë në varësi dhe me nevojat që ka, nivelin e kualifikimit që ofrojnë ata që aplikojnë, si dhe me natyrën e lëndës në raport me strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>

35

natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi IV.2

**Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efëcente dhe efektive**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	Gjatë qëndrimit në mjediset e UAMD, si dhe në hapësirën ku zhvillonte procesin mësimor programi i studimit që kemi në fokus u monitoruan dhe kushtet në të cilat punonin stafi akademik, si dhe personeli mbështetës. Nga vetë specifikat që ka Masteri Profesional “Multimedia dhe Televizioni Dixhital”, procesi i parashikuar në kurrikulë, zhvillohet në mjedise të përshtatshme, bashkëkohore, sidomos tek laboratorit multimedias (që është ndërtuar në kushte si ato që punojnë dhe angazhohen redaksitë audiovizive), si dhe qendra e kompjuterave – ku pedagogët dhe personeli mbështetës janë në rrethana të përshtatshme për të realizuar angazhimin e tyre. Sigurisht që në këto mjedise është shumë efektive dhe aktiviteti i studentëve, si për ndjekjen në kushte të përshtatshme të orëve të leksioneve dhe seminareve, ashtu dhe të kryerjes së detyrave e punimeve, prezantimit të tyre etj.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	Gjatë takimit me stafin akademik që është angazhuar në këtë program studimi, si dhe me drejtuesit në Departament dhe në Fakultet, e evidentua fakti se ka kërkesa për vijueshmëri të kualifikimeve shkencore, në formën e pjesmarrjes në konferenca brenda dhe jashtë vendit apo të publikimeve të artikujve shkencorë. Interesimit të grupit të ekspertëve të jashtëm të vlerësimit nëse pedagogët kishin marrë mbështetje nga UAMD për pjesmarrje në konferenca, apo për realizimin e projekteve të ndryshme- përgjigja nga personeli akademik ishte nuk kanë bërë aplikime pasi ka procedura burokratike të gjata, në rastet kur duan të shkojnë në aktivitete jashtë vendit. Por kanë marrë pjesë në konferencat shkencore që zhvillon UAMD, pasi ato janë pa kosto pjesëmarrjeje.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.	Rishikimi me qëllim përmirësimi dhe pasurimi të leksioneve dhe temave të vecanta që janë pjesë e këtij program studimi, ka shkuar në përshtatje dhe me natyrën e lëndës, si dhe metodat e larmishme të mësimdhënies, të kontrollit të njohurive, të dorëzimit dhe vlerësimit të detyrave e punimeve individuale ose në grup. Nga Departamenti ku përfshihet ky program studimi është kërkuar që për prezantimet të ketë metoda inovative, në një mjedis interaktiv mes pedagogut dhe studentëve. Nga ana e tyre studentët, në takimin me grupin e ekspertëve të jashtëm të vlerësimit e pranuan që nga pjesa më e madhe e pedagogëve aplikoheshin metoda tërheqëse dhe ndihmuese për tematikat që ishin në qendër të programit mësimor e shkencor, si dhe për punët praktike.
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.	Nga shqyrtimi i ngarkesës mësimore të personelit akademik me kohë të plotë, si dhe atyre me kohë të pjeshme, në programin që është në fokus evidentohet ndarje proporcionale e ngarkesës, gjithashtu dhe respektimi i kriterëve të gradave dhe titujve shkencorë, për secilin prej pedagogëve të angazhuar. Ndarja proporcionale e ngarkesës ju lë hapësira stafit akademik për t'u

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

236

	përfshirë në punë shkencore në favor të realizimit të objektivave që ka program i studimit.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

### Standardi IV.3

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Mjediset ku zhvillojnë pjesët e programit teorik studentët e këtij programi studimi janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme, pjesa më e madhe e të cilave realizohet në laboratorin multimedial dhe qendrën e kompjuterave. Sikundër është shpjeguar më sipër, në këtë program nuk përfshihet praktikë profesionale e kryer brenda mjediseve të UAMD, por studentët i kryejnë ato në institucione të tjera, bazuar në marrëveshjet dypalëshe që institucioni ka arritur, si me RTSH, dhe UBT dhe UP. Në Departament morëm informacion për një proces vijues të marrëveshjeve të tjera me njësi mediatike dhe institucione.
<b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Grupi i vlerësimit të jashtëm vizitoi të gjitha mjediset ku zhvillohet procesi mësimor i programit të studimit që është në fokus dhe evidentoi se në klasa kishte videoprojektor, të cilët përdoren për zhvillimin e pjesës së leksioneve dhe seminareve. Gjithashtu grupi qëndroi dhe në laboratorin multimedial, ku ishte studio e zërit (pikoja), si dhe studio audiovizive, si dhe qendrën e kompjuterave (me 20 PC në gjendje pune) dhe ku ishin instaluar programe të ndryshme në funksion të aksesit të studentëve, si dhe realizimit të detyrave apo punimeve të ndryshme.
<b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, ateliet apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Në laboratorin multimedial studentët e këtij program studimi mund të operojnë në grup ose individualisht në procese të tilla, si regjistrimi audioviziv, regjistrimi audio, editimi përmes programeve profesionale të përmbajtjeve të regjistruara deri në sjelljen e tyre në fazën finale gati për regjistrim. Në procesin e postproduksionit ata kanë mundësi dhe për përfshirjen e efekteve të ndryshme, si dhe për prodhimin e spoteve marketues ose trajlerave të ndryshëm. Në këtë mjedis studentët mund të stimulojnë dhe të menaxhojnë formatin e "lidhjeve direkte nga terreni", një situatë që haset në performancën e redaksive audiovizive.
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/eve të studimit që ofron.	Programi që është në fokus ka laboratorin multimedial dhe qendrën e kompjuterave, si dy mjedise shumë të përshtatshme që studentët përmes përdorimit të aplikimeve dhe programeve profesionale janë në gjendje të ushtrohen në modele dhe formate të ndryshme të produkteve multimediale, postproduksion, 3D a animim, thuajse si në kushtet e një redaksie audiovizive. Kjo është në përputhje dhe me kërkesat që ka program i studimit Master Profesional "Multimedia dhe Televizioni Dixhital".
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe /ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të	Aktualisht në mjediset ku realizohet ky program studimi i ciklit të dytë nuk zhvillohen praktika profesionale, shpjeguar kjo dhe më sipër. Studentët i kryejnë praktikat profesionale jashtë UAMD-së.

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

37

posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Standardi IV.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Studentët e programit Master Profesional “Multimedia dhe Televizioni Dixhital” e zhvillojnë mësimin gjatë ditës së premtë, të shtunë dhe të dielë. Ata kanë mundësi që gjatë gjithë ditëve të javës të shfrytëzojnë fondin e bibliotekës që ndodhet në godinën kryesore të UMAD (ku ndodhet Rektorati). Në takimin me studentët, si dhe personelin e bibliotekës u konstatua se interesimi më i madh ishte për sigurimin e literaturës detyruese dhe mbështetëse të lëndëve teorike, pasi për pjesën aplikative të programit ata plotësonin kërkesat duke kërkuar dhe selektuar përmbajtje të shkarkuara online.
<b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Sikundër është shpjeguar më sipër, thuajse e gjithë literatura që ofrohet në lëndët e specialitetit për këtë program studimi Master Profesional është në gjuhën angleze. Në bibliotekë ata priren të shfrytëzojnë publikime më të fundit në fushën e multimedias, të cilat janë në pak kopje, sipas shpjegimit të personelit bibliotekar. Të limituara janë dhe titujt e revistave shkencore të fushës së multimedias si gjendje në fondin e bibliotekës.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Në bibliotekë jepet akses për studentët frekuentues për të qëmtuar përmbajtje periodike, monografi, ose botime të didikuara, të cilat studentëve të programit të studimit që është në fokus të këtij vlerësimi, ju nevojiten për procesin studimor dhe kërkimor, sipas titujve apo autorëve. Bazuar në një mbështetje që UAMD ka marrë nga Federata Ndërkombëtare e Shoqatave dhe Institucioneve Bibliotekare, IFLA, prej 5 viteve është instaluar një program integruar bibliotekar me katalog të një fondi të hapur materialesh virtual, literaturë në dispozicion të studentëve dhe pedagogëve të këtij programi Master Profesional.
<b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	Pjesa më e madhe e kompjuterave nuk ishte në gjendje pune, gjatë kohës së realizimit të vizitës, por kërkimi për literaturën kompesohej nga përdorimi i aparatëve celularë të zgjuar, në kushtet kur në mjediset brenda bibliotekës ishte siguruar wi-fi.
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë e të zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	Fondi i limituar i literaturës për studentët e programit Master Profesional “Multimedia dhe Televizioni Dixhital” në mjediset e bibliotekës argumentohej nga personeli si mungesë buxheti, pa artikulluar ndonjë afat për zgjidhjen e problemit të shtimit të zërave dhe përmirësimin me tituj aktualë të fondit.

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gimn. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

38

<b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj	Gjatë bashkëbisedimit me studentët nga ata u pranua si problem fondi i limituar i bibliotekës për fushën e tyre të studimit, ndërkohë që orari dhe cilësia e shërbimit nga personeli në bibliotekë u përshkrua si korrekt dhe mbështetës për ta.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

<b>Standardi IV.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrohet të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Nga momenti kur një kandidat që interesohet për të kryer studimet në programin e studimit Master Profesional “Multimedia dhe Televizioni Dixhital” fiton të drejtën për të ndjekur procesin studimor, cikli i dytë, gjatë ecurisë së studimeve dhe deri në momentin e diplomimit të dhënat janë në sistemin e menaxhimit. Grupi i ekspertëve të jashtëm ndoqi disa raste të menaxhimit të dokumentacionit të studentëve, nga ata që e kishin kryer ciklin e studimeve në këtë program dhe ishin diplomuar (viti akademik 2018 – 2019) dhe nga ata që vijonin studimet në këtë vit akademik, ku u evidentua mbajtje e rregullt të tyre.
<b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrohet informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Në Departamentin e Teknologjisë së Informacionit ku përfshihet programi i studimit në fokus dinamika e angazhimit të personelit akademik me kohë të plotë, për pedagogët e jashtëm, si dhe personelin mbështetës ruhet dokumentacioni informues dhe vërtetues, si në hard copy ashtu dhe soft copy. Duke filluar nga syllabuset e lëndëve që zhvillohen në program në të dy semestrat, raportimet për periudha të ndryshme mbi zhvillimin e procesit mësimor, përmbledhja e vlerësimeve të studentëve që zhvilloheshin dy herë në vit, korrespondenca me partnerët kryesorë të huaj për programin, si dhe partnerët aktualë dhe potencialë për zhvillimin e praktikave profesionale me studentët etj. Testet që zhvilloheshin me studentët ruheshin për një periudhë jo më pak se një vit, nga data e realizimit në auditor.
<b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Database-a mbi aktivitetin e Departamentit ku përfshihet programi i studimit në fokus, si syllabuset, planet mësimore, kalendari i veprimtarive, pyetësorët e vlerësimit të studentëve, orari për secilin semester, cv-të e personelit akademik e të dhëna të tjera janë të aksesueshme nga stafi, si dhe studentët, si lehtësi, transparencë dhe orientim gjatë zhvillimit të procesit mësimor, por dhe në periudhën e praktikave jashtë institucionit.
<b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të	Për vetë natyrën që ka ky program studimi është instaluar sistem komunikimi virtual mes studentëve dhe pedagogëve që nga njohja me syllabusin e lëndës që do të zhvillohet, regjistrimi për provim, rezultati etj., që bëjnë efikas marrëdhënien e tyre. Për procesin realizimit të

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

39

informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	detyrave ose punimeve nga studentët, si në laboratorin multimedial apo në qendrën e kompjuterave, jo vetëm që gjithë procesi bazohet në komunikimin online, por dhe në çdo moment pedagogu drejtues i lëndës ka njohuri për secilin nga studentët se në cilën fazë të zhvillimit të detyrës ose punimit janë, duke i dhënë mundësi që të asistojë dhe mbështesë pengesat apo paqartësitë e vërejtura.			
<b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Gjatë takimit me drejtuesin e Departamentit dhe stafin akademik të përfshirë u evidentua procesi kapilar i shpërndarjes së materialeve mes tyre, sikundër dhe marshuti i përcjelljes së informacionit nga secili pedagog tek përgjegjësi i njësisë bazë. Kjo vlen për procesin e ndërhyrjeve, për përmirësim ose zgjidhje të atyre aspekteve që paraqiten si të parealizuara, ose që kërkojnë vëmendje të shtuar.			
<b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe	Në faqen zyrtare të institucionit përfshihen në kategorinë e njësisë bazë dhe informacion prezantues mbi programin e studimit që është në fokus të vlerësimit, jepet një përmbledhje shpjeguese mbi natyrën e programit, personelin e angazhuar, si dhe dinamikën e veprimtarive. Veç këtij pasqyrimi, si dhe përmendjes në llogaritë e rrjeteve sociale, specifike është se studentët e Masterit Profesional “Multimedia dhe Televizioni Dixhital” kanë dhe kanal të dedikuar në platformën video sharing YouTube, etiketuar si Multimedia TV, ku shkarkojnë përmbajtje të përgatitura nga ata vetë.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk</b>	<b>Përmbushet</b>	<b>Përmbushet</b>	<b>Përmbushet</b>
	<b>përmbushet</b>	<b>pjesërisht</b>	<b>kryesisht</b>	<b>plotësisht</b>
				<b>X</b>
<b>Standardi IV.6</b>				
<b>Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</b>				
<b>Kriteret</b>		<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>		
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.		Pjesa financiare për mbulimin e kostove të programit të studimit Master Profesional “Multimedia dhe Televizioni Dixhital”, përfshihet në raportin financiar të UAMD-së, në pjesën e njësisë bazë që është Departamenti Teknologji Informacioni. Aty pasqyrohen të gjithë zërat për mbulimin buxhetor të pagave dhe honorareve për personelin me kohë të plotë ose të pjesshëm, stafin mbështetës, për shpenzimet inventarit të domosdoshëm që duhet për mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe kërkimor, për garantimin e proceseve në laboratorin multimedial, në qendrën e kompjuterave, për aktivitetet shkencore, publikimet etj. Duke qenë pjesë e një institucioni publik, buxheti i programit të studimit i nënshtrohet auditeve të brendshme apo nga KLSH, sipas legjislacionit dhe akteve rregullative që janë në fuqi.		
<b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të një programi studi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzo në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura r funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.		Burimet kryesore të të ardhurave që krijojnë fondin e UAMD, pjesë e së cilës është dhe ky program studimi mbeten, buxheti i shtetit, tarifat e shkollimit që paguajnë studentët e regjistruar për të kryer studimet, si dhe të ardhurat që vijnë nga shërbimet që ofron ky institucion për palë të treta. Konkretisht programi i studimit Master Profesional “Multimedia dhe Televizioni Dixhital” përfiton mbështetje dhe nga projekti (partnerët), si është përmendur dhe më herët në pikat e këtij vlerësimi. Programi ka një vit të plotë akademik dhe rreth një muaj në vitin akademik vijues që ka filluar, dhe sipas standardit institucional për Masterin Profesional “Multimedia dhe Televizioni Dixhital”		

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

40



	realizohet analiza periodike financiare, njëvjeçare, të zërave të shpenzimeve dhe të të ardhurave, duke shqyrtuar aspektet e efektivitetit të kostove faktike të kryera, të vitalizimit të të ardhurave në favor të mbështetjes së programit mësimor, si dhe dinamikave të tjera që përbëjnë realizimin e plotë dhe cilësor të kurrikulave. Vetë programi i studimit deri sa të jetë pjesë e projektit me partneritet të huaj, nuk ka vështirësi të dukshme në termat financiarë, por sfidë për Departamentin dhe fakultetin ku është atashuar programi mbetet efektiviteti i kostove si dhe follow up-i, pas mbylljes së projektit.			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.	Nga materiali që ka paraqitur grupi i vlerësuesve të brendshëm në UAMD, si dhe nga prezantimi që u bë nga drejtuesit e Fakultetit dhe të Departamentit, ku përfshihet program i studimit në fokus, u konstatua realizimi në çdo vit i auditimit të brendshëm për ecurinë e aspekteve të shpenzimeve dhe realizimit të të ardhurave. Për vitin e kaluar dinamika ishte në përputhje me planifikimin e bërë nga institucioni.			
<b>Kriteri 4.</b> Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.	Programi në fokus ka të realizuar vetëm një vit akademik të plotë, si dhe rreth një muaj nga viti i dytë. Për vitin e kaluar (2018-2019) ishin analizuar treguesit financiarë, në kuadër të dinamikës së veprimitarisë së Departamentit Teknologji Informatike dhe kanë rezultuar në përputhje me planifikimin e bërë.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni i arsimit të lartë duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen	Siç dhe u përmend më sipër, aktualisht programi i studimit Master Profesional “Multimedia dhe Televizioni Dixhital” është në një stad të mbulimit të një pjese të kostove në kuadër të projektit, ndaj dhe nuk paraqet vështirësi të dukshme në termat financiarë. Sikundër dhe u diskutua në takimet me drejtuesit në Fakultet dhe në Departament, sfidë mbetet efektiviteti i kostove si dhe menaxhimi i programit në periudhën e pasmbështetjes nga ana e projektit. Për këtë nga drejtuesit u shprehën mendime pozitive për sigurimin e qëndrueshmërisë së programit në vijueshmëri.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<b>Standardi V.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Bazuar në rregulloren e miratuar nga UAMD, në pjesën e organizimit të studimit, si dhe rregulloren e Departamentit Teknologji Informacioni, gjithashtu bazuar në të gjitha aktet nënligjore të miratuara nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për aktivitetin e IAL-ve, për programin të studimit që është në fokus, prej vitit të kaluar akademik (2018 – 2019) dhe në vijim, për studentët që ndjekin Masterin Profesional “Multimedia dhe Televizioni Dixhital” ndiqen procedura të standardizuara prej momentit kur ata janë kandidatë që të pranohen dhe pas kësaj regjistrohen për ndjekjen e studimeve; ashtu dhe gjatë kohës kur kryejnë ciklin e plotë njëvjeçar, në dy semestra e deri në momentin kur diplomohen. Grupi i ekspertëve të jashtëm u njoh në sekretarinë mësimore më hollësisht me ndjekjen e të gjitha procedurave, me nxjerrjen e numrit të matrikullimit për secilin student, me hedhjen e vlerësimeve sipas provimeve që ata shlyejnë, si pjesë e programit dhe me vlerësimin përfundimtar të diplomimit.
<b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Që në procesin e shqyrtimit të kandidaturave për ata studentë që shprehin interes për të ndjekur njërin nga profilet e programit të studimit që është në fokus, vlerësimi bëhet pa asnjë diferencim apo selektim, por vetëm duke u bazuar tek pikët që grumbullon secili prej kandidatëve. Po kështu dhe gjatë zhvillimit të programit studentët që frekuentojnë programin përdorin të njëjtat mjedise, kanë të njëjtin akses në database-n që i orienton dhe informon hap pas hapi, shfrytëzojnë të njëjtat mjedise auditorësh, bibliotekare, laboratorin multimedial apo qendrën e kompjuterave – duke garantuar barazi në të drejtat që ata kanë, pa diskriminim, ose favor për persona ose grupe të caktuara.
<b>Kriteri 3.</b> Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë ndjekjes së programit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Në vijim të përgjigjes në pikën e mësipërme, kriteret dhe procedurat e pranimit për studentët e ciklit të dytë të studimit Master Profesional “Multimedia dhe Televizioni Dixhital” bëhen me dije në hapësirën virtuale të Fakultetit ku përfshihet ky program, por dhe për secilin që ka interes për ta ndjekur atë, merren njohuri në sekretarinë mësimore në mënyrë të drejtpërdrejtë, ose nga grupet e informimit që ngre institucioni për fushatën e pranimeve të reja në UAMD. Informimi dhe orientimi i të rinjve apo prindërve ose familjarëve që shprehin interes bëhet pa asnjë diferencim/favor për individë a grupe të caktuara, duke ofruar barazi në akses për të gjithë. Edhe për procedurat e kriteret për rastet e transferimit të studentëve, apo për vlerësimin dhe njohjen e studimeve që studenti ka realizuar më parë në një IAL tjetër, informacioni njohës dhe orientues mund të merret virtualisht, ose nga kontakti i drejtpërdrejtë në Departament, ose në zyrën mësimore të UAMD.
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.	Një kandidat për ndjekjen e këtij programi studimi detyrimisht duhet të ketë kryer një program studimi të ciklit të parë, si dhe të plotësojë kriteret që janë shpallur nga senati i UAMD-së. Pikënisja për kuotat e pranimit në program, si dhe kriteret e rekrutimit të kandidatëve që shpallin interes për programin është propozim i Departamentit Teknologji Informacioni, miratuar ky nga Fakulteti përgjegjës. I gjithë procesi shoqërohet me vendime nga instancat përgjegjëse në UAMD, si dhe me përcaktim të afateve konkrete, se kur duhet të propozohen dhe realizohen procedurat.

<b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit	Përpara fillimit të vitit akademik, në afate të përcaktuara, njoftimet mbi numrin e vendeve dhe kriteret bazike të pranimit të të rinjve kandidatë për ndjekjen e studimeve publikohen në faqen zyrtare të UAMD, si dhe në llogaritë e rrjeteve sociale që ka departamenti. Por informacion njihës mund të merret dhe drejtpërdrejt në mjediset e UAMD, për të gjithë ata student që kanë kryer ciklin e parë të studimeve apo familjarë të tyre, të interesuar për ndjekjen e këtij program studimi me kohëzgjatje 1 vit.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi V.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Në rastin e programit që është në fokus, me kohëzgjatje një vit i plotë akademik, me dy semestra, dinamika e përparimit të secilit student ndiqet nga Departamenti ku përfshihet programi, si dhe nga sekretaria mësimore, përmes të cilës merren në çdo kohë rezultatet e provimeve, për t'i bërë me dije studentit detyrimet e pashlyera, apo dhe të qartësohet për kreditet. Gjithashtu studentët marrin dhe online rezultatet e vlerësimeve në lëndë të ndryshme, sikundër dhe për materialet shpjeguese dhe orientuese që përcjell virtualisht stafi akademik ose Departamenti Teknologji Informacioni.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Për ekuivalentimin e lëndëve të kryera më herët, studentët njihen nga informacioni që shpërndahet në sekretarinë mësimore që mbulon programin që është në fokus, si dhe nga Departamenti. Komisioni që ngrihet për shqyrtimin dhe vlerësimin për rastet e ekuivalentimit të lëndëve njih studentin aplikues në mënyrë të detajuar.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Në javën e parë të fillimit të vitit akademik, që është java orientuese dhe informuese, një nga aspektet që diskutohet gjerësisht me studentët e programit Master Profesional “Multimedia dhe Televizioni Dixhital” është dhe njohja me ato kritere e procedura që do të ndiqen nga stafi akademik, me kohë të plotë ose të pjesshme, me metodologjinë e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve gjatë realizimit të programit të studimit. Nga takimi me studentët e programit në fokus u evidentua fakti se kjo është realizuar dhe në vitin akademik 2018-2019, si dhe atë 2019-2020 që është në vijim.
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Në vijim të shpjegimit të mësipërm, e njëjta praktikë është ndjekur dhe për sqarimin e kriterëve dhe procedurave të punimit të diplomës. Siç është shpjeguar më sipër, në vitin e kaluar akademik nuk ka pasur punim diplome, por për të gjithë studentët e Masterit Profesional “Multimedia dhe Televizioni Dixhital” (viti akademik 2018-2019) është realizuar provim përfundimtar. Për këtë vit vijues akademik drejtues të Fakultetit dhe Departamentit konfirmuan se do të aplikohet formati i punimit të diplomës.
<b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të	Bazuar në rregulloret e UAMD, si dhe praktikave që ndiqen nga programe të ndryshme të studimit të ciklit të dytë, përfshirë dhe programin që është në fokus, që përpara se të fillojë procesi i aplikimeve dhe regjistrimit të studentëve bëhet publikimi njihës përmes hapësirës virtuale të UAMD i

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

12/43

interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit	udhëzimeve mbi kriteret që ndiqen për këtë proces. Njohja realizohet dhe përmes broshurave hard dhe soft copy, përmes takimeve që zhvillojnë grupe nga institucioni me studentë të cilët kanë mbaruar ciklin e parë të studimit, si dhe nga publikimi i përmbajtjeve audiovizive në llogaritë e rrjeteve sociale. Fakt është që kontigjenti kryesor i studentëve që ndjekin këtë program studimi janë nga ata që kanë kryer ciklin e parë po në këtë degë në UAMD, të cilët në përfundim të diplomimit në Bachelor, informohen dhe orientohen për programin Master Profesional “Multimedia dhe Televizion Dixhital”.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi V.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Mbi programin e studimeve gjatë një viti akademik, aq sa dhe kryet i plotë Masteri Profesional “Multimedia dhe Televizioni Dixhital”, studentët kanë mundësi të njihen që para se ata të regjistrohen nga publikimi virtual i kurrikulës së plotë në faqen zyrtare të institucionit, ku janë shkarkuar dhe dokumente të tjera bazike mbi organizimin në rang universiteti, fakulteti apo departamenti (ku përfshihet dhe program në fokus). Gjithashtu një mundësi tjetër më e detajzuar për njohje është dhe java e parë e fillimit të vitit akademik, shpjeguar më sipër, ku nga Departamenti ose nga pjestarë të stafit akademik jepen sqarime dhe orientime mbi strukturën, organizimin e procesit studimor, mbi mjediset konkrete ku do të zhvillohet mësimi, detyrimet lëndore për secilin semester etj.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Në vijim të përgjigjes për kriterin e mësipërm, studentëve ju jepet në javën e parë të orientimit, si dhe në mënyrë të vazhdueshme gjatë përparimit të vitit akademik informacion i detajzuar dhe për lëndët ose modulet përbërës, të ndara këto në secilin prej dy semestrave, kreditet për secilën, si dhe veprimtaritë formuese. Interaktiviteti në hapësirën virtuale, përfshin dhe shkëmbim informacioni mbi format e zhvillimit të lëndëve, ose aktivitetet e planifikuara për t’u realizuar në kuadër të programit.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Në takimin që u zhvillua me përfaqësues të Zyrës së Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës, por dhe gjatë takimeve të tjera që zhvilloi mbi programin grupi i ekspertëve të jashtëm u fokusua dhe tek informimi rreth mundësive të punësimit të studentëve që ndjekin këtë program studimi, rreth mbështetjes që atyre u jepej për këtë. Kjo realizohej duke publikuar njoftime për punësim në faqen zyrtare të institucionit, në pjesën që i dedikohet Departamentit, ku përfshihet programi i studimit, por dhe përmes njoftimeve të drejtpërdrejta me studentët në auditor.
<b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe	Përmes sistemit të komunikimit online AULA, studentët që ndjekin këtë program studimi marrin info dhe orientim duke përdorur llogarinë e tyre nga aksesimi që marrin me password të personalizuar, ku njihen me kurrikulën, oraret, me notat për secilin provim të kryer, me detyrimet që duhet të shlyejnë për të vijuar përparimin në programin që ndjekin etj. Gjithashtu

shërbimet në funksion të realizimit të tij.	informacion ata marrin dhe për mjediset ku do të zhvillohen lëndët, si numrat e auditorëve, ashtu dhe për laboratorin multimedial dhe qendrën e kompjuterave, si dy hapësirat më të rëndësishme ku realizohet pjesa më e madhe e programit të studimit, në dy semestrat e vitit akademik.			
<b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë	Interaktiviteti përmes komunikimit online, u jep mundësi studentëve që të kenë akses dhe në distancë, duke shqyrtuar e nxjerrë info që atyre ju nevojiten për të ndjekur dinamikën e zhvillimit të programit që janë regjistruar, si dhe për detyrimet që kanë mbetur për t'u realizuar.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Në përmbushje</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi V.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë*, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.	Në sekretarinë mësimore që mbulon aktivitetin e këtij programi studimi na u prezantuan të gjitha statistikave që i takojnë vitit të kaluar akademik (2018-2019), për ata studentë që kishin kryer ciklin e plotë, në dy semestra dhe ishin diplomuar.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Statistikave për vitin e kaluar akademik, 2018 – 2019, për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit të ciklit të dytë Master Profesional “Multimedia dhe Televizioni Dixhital”, si dhe rastet kur ata ende nuk i kishin shlyer detyrimet për të fituar diplomën iu paraqitën grupit të vlerësuesve të jashtëm në sekretarinë mësimore si dhe në Departament. Sigurisht që këto statistika po mbahen dhe për vitin akademik vijues, 2019-2020.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.	Për progresin në realizimin e programit studimor, për secilin prej studentëve, sekretaria mësimore posedon të dhëna të detajuara (në formën e procesverbaleve të notave, si dhe të dhëna që hidhen në regjistrin e posaçëm me fletë të veçanta për çdo student), deri sa arrihet në fazën e akordimit të diplomës së ciklit të dytë Master Profesional “Multimedia dhe Televizioni Dixhital”, të dhëna që ju prezantuan dhe grupit të vlerësuesve të jashtëm.
<b>Kriteri 4.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Tashmë që një vit i plotë akademik është aplikuar me këtë program, të gjitha të dhënat e studentëve (të regjistruar, të diplomuar, që nuk e kanë marrë ende diplomën, rezultatet e tyre sipas lëndëve/moduleve, përgjigjet që ata kanë dhënë për pyetësorët, në fund të dy semestrave etj.) janë si file më vete në sistemin e brendshëm të informacionit, dhe këto të dhëna mund të shfrytëzohen dhe hulumtohen nga të gjithë personat e interesuar, të autorizuar.
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë të punësimit të tyre, duke e shoqëruar me	Për vitin e parë akademik që është aplikuar programi që është në fokus, 2018 – 2019, grupit të vlerësuesve të jashtëm iu paraqitën të dhëna nivelin e studentëve (mesatarja në hyrje dhe në dalje), si dhe një listë e aktualizuar e punësimit të tyre pas kryerjes së Masterit Profesional “Multimedia dhe

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve	Televizioni Dixhital” – të dhëna që evidentojnë mbajtjen e situacioneve, mbi bazën e të cilave hartohet nga Departamenti i Teknologjisë së Informacionit analiza për ecurinë, arritjet, aspektet ku duhet ndërhyrje për përmirësim etj. Të dhënat për mesataren e pranimit dhe atë të diplomimit e harton sekretaria mësimore, e cila mbulon këtë program studimi, dhe ja kalon më pas Zydrës së Këshillimit, Alumnit dhe Karrierës dhe Departamentit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	UAMD ka të garantuar në rregulloren e miratuar dhe pjesën mbi të drejtat dhe detyrat e studentëve, lirinë e organizimit të tyre, të cilat janë të reflektuar dhe në rregulloren e Fakultetit ku përfshihet programi i studimit në fokus. Studentët e Masterit Profesional “Multimedia dhe Televizioni Dixhital” e konfirmuan këtë gjatë takimit me grupin e ekspertëve të jashtëm.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Studentët e këtij programi studimi e frekuentojnë procesin mësimor tri ditë në javë (të premte, të shtunë dhe të dielë), por kjo nuk i ka penguar dhe nuk i pengon që të përfshihen në dinamikën e UAMD-së, më specifikisht tek Fakulteti dhe Departamenti ku përfshihet programi i tyre. Nga takimi me ta u evidentua qëndrimi proaktiv i tyre në diskutimet për aspektet brenda dhe jashtë auditorëve, të kërkimit shkencor dhe praktikave profesionale. Ata kanë përcjellë në Departament dhe Dekanat mendime për kurrikulën, meqënëse ata janë dhe gjenerata e parë e këtij programi. Mendime dhe sugjerime ata kanë shprehur dhe në plotësimin e pyetësorëve, në vitin e kaluar akademik 2018-2019.
<b>Kriteri 3.</b> Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, duke përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.	Programi i studimit në fokus është i ri në UAMD. Ai është aplikuar në një vit të plotë akademik, vijon aktualisht me gjeneratën e dytë të studentëve. Patjetër që në kushte të tilla, procesi i përmirësimit të kurikulës, i ndryshimeve dhe përshtatjeve për të standardizuar cilësinë do të vazhdojë dhe në këtë proces rol kanë dhe studentët. Departamenti dhe dekanati i Fakultetit janë të angazhuar që krahas mendimeve dhe vlerësimeve të stafit akademik, të partnerëve të huaj që koeporojnë me këtë program, të marrin në konsideratë dhe gjykimet e studentëve, duke iu referuar propozimeve dhe opinioneve të tyre në pyetësorët, apo ato që ata shprehin drejtpërdrejt në analiza dhe konsultime të ndryshme.
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.	Duke vijuar përgjigjen e kriterit të mësipërm, në programin e studimit “Multimedia dhe Televizioni Dixhital” vlerësohet kontributi i studentëve mbi hartimin, rishikimin dhe përmirësimin e mëtejshëm të kurrikulave, të metodologjisë së mësimdhënies, të ndarjes proporcionale të krediteve për secilën lëndë etj.

46

<p><b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Gjatë takimit me studentët që e kanë kryer ciklin e dytë në këtë program studimit (për vitin akademik 2018-2019), por dhe ata që e vijnë aktualisht, u evidentua angazhimi i tyre për përcjelljen në Departament e Dekanat të medimeve dhe propozimeve mbi ecurinë e kurrikulës në tërësi, ose për lëndë specifike, për raportin e pjesës teorike dhe asaj aplikative etj.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p><b>Standardi V.6</b>  <b>Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>Në takimin që grupi i ekspertëve të jashtëm realizoi me përfaqësues të sektorit të Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës, u njoh me procedurat që ata ndjekin për të orientuar dhe mbështetur studentët në menaxhimin e ankesave dhe problemeve që ata hasin, si dhe për përballuar procesin e përparimit të programit të studimit deri në finalizimin me diplomë.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. .</p>	<p>Si një program i ri studimi sektori i Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës, si dhe Departamenti i Teknologjisë së Informacionit asistojnë studentët në lehtësimin e orientimit të tyre për strukturën e kurrikulës që aplikohet, metodologjinë e vlerësimit dhe shlyerjes së detyrimeve, të informimit për shfrytëzimin e literaturës së nevojshme në mjediset e bibliotekës etj..</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Jo vetëm asitohet realizimi i programit të studimit, për secilin semestër, por studentët informohen dhe orientohen dhe për kryerjen e praktikës profesionale. Kjo për faktin se ajo kryet jashtë mjedisve të UAMD dhe nevojiten njohuri shtesë për opcionet që ofrojnë institucione të tjera. Ndërkohë, sektori i Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës, si dhe Departamenti ku përfshihet ky program studimi, kanë në fokus dhe orientimin e studentëve në tregun e punës.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të</p>	<p>Sic dhe u përmend më sipër, grupit të ekspertëve të jashtëm iu paraqit dhe një listë mbi punësimin e studentëve që e kishin kryer diplomimin në ciklin e dytë të studimit Master Profesional “Multimedia dhe Televizion Dixhital” në vitin akademik 2018-2019, aspekt që tregon se Departamenti dhe sektori i Karrierës, Alumnit dhe Komunikimit në</p>

programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve, organeve dhe autoriteteve drejtuese përkatëse	UAMD ndiqte dinamikën e ecurisë së studentëve dhe pas diplomimit të tyre.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER PROFESIONAL

<b>Standardi VI.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet regullatore institucionale.	<p>UAMD ka miratuar “Rregullore për Funkionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë”.</p> <p>UAMD i përmbahet Standardeve Europiane kryesore për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, duke specifikuar:</p> <p>Standardi 1: Politika për sigurimin e cilësisë</p> <p>Standardi 2: Hartimi dhe miratimi i programeve</p> <p>Standardi 3: Të nxënit, mësimdhënia dhe vlerësimi me në qendër studentin</p> <p>Standardi 4: Pranimi i studenteve, progresi, njohja e krediteve dhe diplomimi i tyre</p> <p>Standardi 5: Personeli akademik</p> <p>Standardi 6: Burimet e të nxënit dhe mbështetja për studentin</p> <p>Rregullorja ka të përcaktuar qartësisht se cilat janë strukturat përgjegjëse, sipas Nenit 2 ku përcakton se “...Në nivel Institucional strukturat përgjegjëse për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë janë: (i) Senati Akademik; (ii) Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve dhe Cilësisë (KPGSC); (iii) Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (DKSC)/Koordinatori Institucional pranë ASCAL (KIAL); (iv) Drejtoria e Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë (DKSC).</p> <p>Ndërsa në nivel Fakulteti përgjegjës për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë janë: (i) Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë pranë Fakulteteve (NjBSC Fakulteti); (ii) Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për çdo program (GVB.Bch. /GVB.MP. /GVB.Msc.); (iii) Koordinatorët e Programeve (Ko.Bch. / Ko.MP / Ko.Msc.)”</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>UAMD ka miratuar dhe ka në funksionim Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë e cila ka si detyrë:</p> <p>a) Përgatitjen e raporteve periodike (3-mujorë, 6-mujorë dhe vjetorë) të vetëvlerësimit të cilët i propozohen Senatit Akademik për miratim nga KPGSC.</p> <p>b) Rritjen e ndërgjegjësimit të brendshëm mbi çështjet e cilësisë.</p> <p>c) Evidentimin pranë fakulteteve dhe njërive të tjera pranë UAMD-së pikat e tyre të forta dhe të dobëta, së bashku me sugjerimet e marra për zhvillimin e veprimtarive të tyre për të përmirësuar më tej pikat e forta dhe për të minimizuar në mënyrë të vazhdueshme dobësitë.</p> <p>d) NjBSC në nivel institucional realizon misionin e saj në bashkëveprim me NjBSC-në në nivel Fakulteti.</p> <p>e) Merr masa parapërgatitore për vlerësimin e jashtëm të cilësisë.</p> <p>f) Angazhohet në trajnimin dhe zhvillimin profesional për çështjet e “cilësisë”, si dhe kompetencave të tjera funksionale të stafit akademik dhe atij administrativ.</p> <p>“Rregullorja për Funksionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë” përmbledh gjithë detyrat e NjBSC dhe kompetencat e saj institucionale.</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>NjBSC është organizmi qëndron që koordinon punën në rang fakulteti si edhe universiteti për sigurimin e cilësisë.</p> <p>UAMD ka kaluar akreditimin institucional me Vendimin e Bordit Nr. 10 datë 07.04.2017 me një akreditim akademik për 4 vite. dhe tani ka në proces akreditimi të disa programeve mësimore.</p> <p>Në proces akreditimi me vlerësuesit e ASCAL ka filluar me programet Master dhe me tej edhe programet Bachelor.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>Rregullorja për Funksionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë në nenin 2 të saj nënvizon se “...Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Brendshëm të cilësisë (KPGSC) mbikqyr dhe pranon raportet 3-mujore, 6-mujore dhe ato vjetore që përgatiten nga NjSBC dhe nëse gjykohet e nevojshme i kthen ato me sugjerime apo rekomandime për reflektim të mëtejshëm”.</p> <p>Ky Komisioni i Përhershëm është përgjegjës dhe struktura që e djek në vazhdimësi dhe e garanton përmirësimin e cilësisë në UAMD.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p><b>X</b></p>

**Standardi VI.2**

**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njëjësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ngre njësi të posaçme për monitorimin,</p>	<p>Rregullorja për Funksionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë ka të qartësuar edhe detyrat e NjSBC pranë çdo fakulteti</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

49

shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të dytë.	<p>si edhe rolin e kordinatorit të programit të studimit në funksion ruajtjes së cilësisë. Koordinator i programit të studimit në UAMD krahas detyrave të tjera kujdeset për garantimin e suksesit të studentëve në universitet. Koordinator i programit ka edhe detyrë si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Raporton pranë dekanit dhe NjBSC-së mbi cilësinë dhe standardet e programit që mbikëqyr;</li> <li>▪ Përgatit raporte vjetore, dhe kur kërkohet nga NjBSC-ja gjatë një procesi akreditimi, mbi programin që mbikëqyr, duke u bazuar në formatet e përcaktuara nga NjBSC-ja;</li> <li>▪ Përgatit dhe rifreskon në mënyrë të vazhdueshme studimin e tregut mbi programin që mbikëqyr;</li> <li>▪ Përgatit dhe rifreskon në mënyrë të vazhdueshme dosjen e programit që mbikëqyr;</li> <li>▪ Në bashkëpunim me kordinatorin e departamentit për kërkimin shkencor, përgatit një raport vjetor, dhe kur kërkohet nga NjBSC-ja gjatë një procesi akreditimi, mbi veprimtarinë kërkimore-shkencore.</li> </ul>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të dytë.	UAMD, për mbikëqyrjes e herëpashershme të programeve mësimore të ciklit të dytë, përdor procese formale shqyrtimi dhe miratimi. Prosesi i vlerësimit të brendshëm udhëhiqet nga kordinatorët e programit mësimor. Për këtë proces vlerësimi përdoren si të dhënat sasiore ashtu edhe ato cilësore të grumbulluara në forma të ndryshme, nga pyetsorë fokus grupet me studentët dhe komunikimit e drejtëpërdrejtja.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.	<p>Kordinatorët e programave të studimit në bashkëpunim me NjBSC hartojnë disa tregues mbi institucionin për ecurinë e programeve dhe të studnetëve brenda një programi. Sipas “Rregullores për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë” (Kreu i Pestë, Neni 15) të dhënat kryesore statistikore përfshijnë: (i) Ecurinë e studentëve dhe nivelet e suksesit; (ii) mundësitë e punësimit të të diplomuarve; (iii) profilin e popullatës studentore; (iv) raportin pedagog/studentë; (v) plotësimi i kërkesave të studentëve me programet e tyre; (vi) efektivitetin e pedagogëve; (vii) koston e burimeve të mësimnxënies dhe disponueshmërinë e tyre; (viii) monitorimin e situatës së punësimit të të diplomuarve; (ix) nivelin e largimit/transferimit të studentëve; (x) numrin e stafit dhe studentëve që pranohen dhe largohen.</p> <p>Po kjo rregullore përcakton edhe Treguesit Kyç të Performancës sic janë: (i) Ruajtja e nivelit të regjistrimeve; (ii) nivelet e kalueshmërisë; (iii) nivelet e diplomimit; (iv) diversiteti i profileve studentore, etj. Këto të dhëna mblidhen në nivel fakulteti dhe i dërgohen NjBSC-së, çdo fillim viti akademik. Më tej ajo ka për detyrë të japë mendim në formën e sugjerimeve dhe masave korrigjuese. Të dhënat, sugjerimet dhe masat korrigjuese shqyrtohen nga KPGSC-ja, dhe më pas i propozohen Senatit Akademik për miratim.</p>
<b>Kriteri 4.</b> Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	<p>Pas hartimit dhe miratimit të treguesve kyç të performancës dekanët e fakulteteve, në konsultim me stafin akademik të çdo departamenti, përcaktojnë prioritetet e fakulteteve për t'i renditur me prioritetet e universitetit.</p> <p>Rishikimi vjetor i veprimtarisë akademike dhe kërkimore shkencore përgatitur nga NjBSC-ja, i cili përfshin, në numrin e studentëve që</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

50

	diplomohen, numrin e publikimeve dhe kërkimeve shkencore, mënyrën sesi funksionon sistemi i sigurimit të cilësisë, si dhe çdo ankesë për funksionimin e sistemit përdoret si tregues i performacës. Ky është një instrument i dobishëm për NjBSC-në, KPGSC-në dhe Senatën Akademikë për shqyrtimin e fushave problematike dhe marrjen e vendimeve rreth alokimit të burimeve dhe zhvillimeve të ardhshme.			
<b>Kriteri 5.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë	Raportet e vlerësimit përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë. Për këtë shërben edhe formulari i vetëvlerësimit dhe raporti vjetor i publikua për monitorimin e cilësisë.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Asnjë përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi VI.3</b>	
<b>Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësi e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.	Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, GVJ, krahas dokumentave të tjerë kishte edhe formatet e pyetësorëve me studentët dhe stafin të zhvilluar për kontrollin periodik të cilësisë. NjBSC kryen vlerësimin periodik të programeve të studimit nëpërmjet formave të ndryshme duke krahasuar objektivat e vendosur dhe rezultatet e pritshme në krahasim me realizimit faktike.
<b>Kriteri 2.</b> Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.	Sipas Nenit 6 “Sigurimi i cilësisë” të “Rregullores për Funksionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë” vlerësimi i cilësisë sigurohet nëpërmjet: <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Pyetësorit të studentit, i cili propozohet nga KPGSC dhe miratohet nga Senati Akademik;</li> <li>▪ Vlerësimit të përgjegjës të departamentit për çdo anëtar të stafit të tij me kohë të plotë, duke u bazuar në përmbushjen e detyrimeve administrative dhe akademiko-shkencore;</li> <li>▪ Vlerësimit të drejtuesit të njësisë kryesore për stafin që ai drejton. Ky pyetësor zhvillohet në fund të semestrit të dytë, brenda muajit Qershor, dhe së bashku me vlerësimin e studentëve i vihet në dispozicion Rektoratit.</li> </ul>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda të drejtpërdrejta, si: vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës,	Pyetësi është një nga format më të përdorura të vlerësimit statistikor për arritjen e objektivave të ndryshme në UAMD. Për të vëzhguar mbarëvajtjen dhe cilësinë e e programit të studimit në universitet realizohen: <ol style="list-style-type: none"> <li>a) Pyetësorit të studentëve, të cilët vlerësojnë institucionin;</li> <li>b) Pyetësorit të stafit akademik, i cili vlerëson institucionin;</li> <li>c) Pyetësorit të stafit administrativ, i cili vlerëson institucionin.</li> </ol> <p>Cilësia e shërbimeve të ofruara nga institucioni për studentët matet kryesisht nga hartimi dhe zbatimi i politikave për shërbimet inovative në universitet,</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

51

<p>testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>infrastrukturës, faciliteteve, bibliotekës, shërbimeve nga ana e sekretarive mësimore, teknologjisë së informacionit etj. Ky vlerësim realizohet një herë në vit, zakonisht brenda muajit Qershor të çdo viti akademik. Procesi i shpërndarjes së pyetësorëve dhe mbledhjes së të dhënave realizohet nga DKSC e cila ja paraqet rezultatet e tyre Rektorit, Administratorit, KPGSC dhe Senatit Akademik për analiza të mëtejshme. Edhe në këtë rast, formati i pyetësorëve propozohet nga KPGSC dhe miratohet nga Senati Akademik.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>Programi Master Profesional “Multimedia dhe Televizion Dixhital” është ndërtuar falë bashkëpunimit dhe financimit në kuadër të projektit BE “Development and Implementation of Multimedia and Digital TV Curricula (DIMTV)” program “Erasmus +”. Janë tre universitete të huaja që kanë asistuar në hartimin e kurikulave. Keto universitete janë pjesë e projektit DIMTV i cili ka në përbërje edhe komponentin për vlerësimin e ecurisë së realizimit të projektit. Kështu për vlerësimin e ecurisë së këtij programi mësimor përdoret edhe një vlerësim i tërthortë nëpërmjet pyetësorit për arritjen e rezultateve të projektit. Kurikula mësimore është vlerësuar për ecurinë dhe realizimin e saj edhe nga dy ekspertë të huaj.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht <b>X</b></p>

<p><b>Standardi VI.4</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Sipas kuadrin nënligjor, rregullaoreve të miratuara nga Senati akademik, Statutit të UAMD dhe Kodit të Etikës, Universiteti Aleksandër Moisiu i Durrësit ka të ngritur strukturat dhe procedurat që garantojnë përfshirjen e aktorëve si të brendshëm ashtu edhe të jashtëm në sigurimin e cilësisë. Vlerësimi i brendshëm bëhet nga struktura përkatëse sipas përcaktimit në “Rregullore për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë”. Nga pikëpamja institucionale sipas edhe nenit 2 të rregullores së lartpërmendur, në nivel Institucional strukturat përgjegjëse për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Senati Akademik;</li> <li>2. Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve dhe Cilësisë (KPGSC);</li> <li>3. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (DKSC)/Kordinatori Institucional pranë ASCAL (KIAL);</li> <li>4. Drejtoria e Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë (DKSC);</li> </ol> <p>Ndërsa në nivel Fakulteti përgjegjës për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë pranë Fakulteteve (NjBSC Fakulteti)</li> </ul>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



52



	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për çdo program (GVB.Bch. /GVB.MP. /GVB.Msc.)</li> <li>▪ Koordinatorët e Programeve (Ko.Bch. / Ko.MP / Ko.Msc.)</li> </ul> <p>Organigrama ka të përcaktuar qartë edhe detyrat dhe të drejtat e secilit nga personat në funksionet e mësipërme duke detajuar edhe funksionet për kontrollin e cilësisë.</p>								
<b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.	Në Njësinë Bazë për Teknologjinë e Informacionit ka një bashkëpunim mjaft të mirë për midis stafit akademik dhe atij ndihmës në shërbim të realizimit të programit mësimor Master Profesional “Multimedia dhe Televizion Dixhital”. Kjo u vu re edhe gjatë vizitës dhe takimeve që GJV bëri në institucion. Bashkëpunimi është i materializuar edhe në rregulloret dhe përshkrimet e punës të miratuara nga Senati Akademik.								
<b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	UAMD respekton integritetin akademik dhe shmang diskriminimin dhe pabarazinë në vlerësim, si për studentët dhe petagogët.								
<b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj	Partnerët në konsorciumin e universiteteve evropiane, në kuadër të projektit janë përfshirë edhe në procesin e vlerësimit të cilësisë dhe programit nësimor dhe realizimit të saj. Kurikula e vitit të parë kur u hap programi është ndërtuar nga konsultimi me universitetet partnere nw Slloveni, Estoni (UL), Çeki (VSB-TUO).								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

### Standardi VI.5

**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të SBC për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	<p>UAMD ka një faqe interneti qe ka të përfshira disa nënfaqe me informacione institucionale të cilat ndihmojnë në publikimin dhe transparencën e informacionit. UAMD a një rregullore specifike për sigurimin e Brendshëm të Cilësisë.</p> <p>Nënfaqet në Internet të UAMD me informacione janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. <a href="http://www.dimtv-project.al">www.dimtv-project.al</a></li> <li>2. Lista e Prioriteteve Kombëtare për thirrje për projekte Erasmus+ 2017 <a href="https://eacea.ec.europa.eu/erasmus-plus/funding/capacity-building-in-field-higher-education2017_en">https://eacea.ec.europa.eu/erasmus-plus/funding/capacity-building-in-field-higher-education2017_en</a></li> <li>3. Vendim i Bordit të Akreditimit, Nr. 10, datë 07/04/2017 “Për Akreditimin e parë të Institucionit të Arsimit të Lartë Universiteti Aleksandër Moisiu Durrës <a href="https://www.ascal.al/index.php?option=com_k2&amp;view=item&amp;layout=item&amp;id=97&amp;Itemid=698&amp;lang=sq">https://www.ascal.al/index.php?option=com_k2&amp;view=item&amp;layout=item&amp;id=97&amp;Itemid=698&amp;lang=sq</a></li> <li>4. <a href="https://www.facebook.com/uamdofficial/">https://www.facebook.com/uamdofficial/</a></li> </ol>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

53

	<p>5. <a href="https://www.facebook.com/AlumniUAMD/">https://www.facebook.com/AlumniUAMD/</a>  6. <a href="https://www.facebook.com/FTIUAMD/">https://www.facebook.com/FTIUAMD/</a>  7. <a href="https://www.facebook.com/multimedia.fti.uamd">https://www.facebook.com/multimedia.fti.uamd</a>  8. <a href="https://www.facebook.com/dimtval/">https://www.facebook.com/dimtval/</a>  9. <a href="https://www.uamd.edu.al/index.php/sq/fakulteti-i-teknologjise-se-informacionit/">https://www.uamd.edu.al/index.php/sq/fakulteti-i-teknologjise-se-informacionit/</a>  10. <a href="https://www.youtube.com/channel/UC26J1hWuOri6WKYMo0QnqLg">https://www.youtube.com/channel/UC26J1hWuOri6WKYMo0QnqLg</a>  11. <a href="https://www.youtube.com/channel/UCB5JXbriwSaBrQVGOQBvcHw">https://www.youtube.com/channel/UCB5JXbriwSaBrQVGOQBvcHw</a>  12. <a href="https://www.instagram.com/multimediatvd/">https://www.instagram.com/multimediatvd/</a>  13. <a href="https://www.instagram.com/uamdoofficial/">https://www.instagram.com/uamdoofficial/</a>  14. <a href="https://www.uamd.edu.al/index.php/sq/dokumente/">https://www.uamd.edu.al/index.php/sq/dokumente/</a></p>				
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Një nga nënfaqet e Internetit të faqes zyrtare të UAMD ka edhe programin e transparencës.</p> <p>Rezultatet e vlerësimit janë të bëra publike në rang institucional dhe jo për secilin pedagog në veçanti, duke respektuar legjislacionin për të dhënat personale. Ndërkohë Përgjegjësit të NJKTI i dërgohet informacioni i plotë dhe ai komunikon me të gjithë pedagogët.</p> <p>Programi i transparencës  <a href="https://www.uamd.edu.al/index.php/sq/programi-i-transparences/">https://www.uamd.edu.al/index.php/sq/programi-i-transparences/</a></p> <p>Në site e universitetit tek shërbime/ dokumenta gjenden info për rregullore dhe statute të publikuar <a href="https://www.uamd.edu.al/index.php/sq/dokumente/">https://www.uamd.edu.al/index.php/sq/dokumente/</a>  <a href="https://www.uamd.edu.al/index.php/sq/fakulteti-i-teknologjise-se-informacionit/departamenti-i-teknologjise-se-informacionit/multimedia-dhe-televizion-digjital/">https://www.uamd.edu.al/index.php/sq/fakulteti-i-teknologjise-se-informacionit/departamenti-i-teknologjise-se-informacionit/multimedia-dhe-televizion-digjital/</a></p>				
<p><b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Institucioni bën vlerësimin e rezultateve nga pyetsorët dhe i kombinon ato me vlerësimet e tjera të drejtpërdrejta në procesin mësimor. Në rastet kur ka problematika, ekziston mundësia për të ndryshuar kushtet, kohën e angazhimit të lektorëve me kohë të plotë ose të pjesëshme.</p>				
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>UAMD dhe njësitë kryesore të saj janë përgjegjëse për mbledhjen e gjithë informacionit nga pyetsorët si me studentët ashtu edhe me stafin akademik dhe ndihmës. Informacionet e marra nga këta pyetsorë janë pjesë edhe e raportimeve të ndryshme periodike që bën njësitë kryesore respektive. Raportet për monitorimin e cilësisë shpërndahen me stafin akademik dhe diskutohen për përmirësim të mëtejshëm të programeve të ndryshme mësimore.</p>				
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit</p>	<p>UAMD ka të ndërtuar një strukturë organizative funksionale të bazuar në rregulloren e brendshme dhe në statutin e saj. Rregullorja përcakton të gjitha detyrat funksionale në të gjitha nivelet që lidhen me sigurimin e brendshëm të cilësisë. Për secilin nga programet mësimore, është koridatori i programit që është përgjegjës për sigurimin e cilësisë. Kordinatori i programit dhe përgjegjësi i NJKTI në rastin e programit Master Profesional “Multimedia dhe Televizion Dixhital” sigurohen për mbarëvjetjen e cilësisë.</p> <p>Gjatë vitit 2018-2019, duke qënë se ky ka qënë viti i parë në realizimin e këtij programi master dhe grupi i studentëve ka qënë mjaft i vogël, i gjithë ekipi i pedagogëve dhe stafi akademik dhe koordinatori i programit kanë pasur kontakte të vazhdueshme me studentët për të ti informuar dhe marrë nga ata këndvështrime për përmirësimin e cilësisë.</p>				
	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbyshet</td> <td>Përmbyshet pjesërisht</td> <td>Përmbyshet kryesisht</td> <td>Përmbyshet plotësisht</td> </tr> </table>	Nuk përmbyshet	Përmbyshet pjesërisht	Përmbyshet kryesisht	Përmbyshet plotësisht
Nuk përmbyshet	Përmbyshet pjesërisht	Përmbyshet kryesisht	Përmbyshet plotësisht		


54

Shkalla e përbushjes së standardit				X
------------------------------------	--	--	--	---

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës VI	Përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X



55



**Përfundime të vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional “Multimedia dhe Televizion Dixhital” me profile Produksion dhe Postproduksion; Animim 3D dhe Përpunim Imazhi të Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti Aleksandër Moisiu Durrës”**

**Pikat e forta dhe afirmime**

1. Programi Master Profesional “Multimedia dhe Televizioni Dixhital” është ndërtuar falë bashkëpunimit dhe financimit në kuadër të projektit BE “Development and Implementation of Multimedia and Digital TV Curricula (DIMTV)” program “Erasmus +”.
2. Bashkëpunimi me institucionet ndërkombëtare dhe universitetet e huaja për ndërtimin e programit, duke marrë eksperiencë në fushën e studimit ku fokusohet programi.
3. Vazhdimësia e programit nga studimet në ciklin e parë Bachelor dhe mundësia e përthithjes së studentëve nga ai program studimi.
4. Bashkëpunim mjaft i mirë midis stafit akademik dhe studentëve
5. Laboratori i multimedias dhe qendra e kompjuterëve janë të pajisur mjaft mirë, duke plotësuar nevojat për zhvillimin e lëndëve të kategorive B dhe C.
6. Ndërthurja dhe bashkëpunimi me departamentet e tjera të UAMD për të pasqyruar mediatikisht aktivitetet që zhvillohen në Universitet.

**Pika të dobëta**

1. Mungesa e stafit akademik me tituj dhe grada shkencore për fushën specifike të multimedias dhe teknologjisë dixhitale në vend.
2. Përshtatje e jo tërësore (jo e të gjithë kapitujve) në përmbajtjen e programit të lëndës së Matematikës për Multimedia me profilin e studimit për një Master Profesional në “Multimedia dhe Televizioni Dixhital”.
3. Literatura që rekomandohet në lëndët që zhvillohen në këtë program studimi është vetëm në gjuhën angleze.
4. Mungesa e një rrjeti të qëndrueshëm me institucione dhe subjekte publike e private, të përshtatshme dhe efektive ku të atashohen studentët e këtij programi studimi në kryerjen e praktikave profesionale

**Rekomandime**

1. Programi i lëndës “Matematikë për Multimedia” në opinion e GVJ, duhet të ketë më pak orë mësimore dhe më pak kredite në këtë program studimi. Kjo lëndë është e kategorisë A. Profili i këtij programi studimi nuk ka nevojë për informacione aq të detajuara sa jepen sipas syllabusit ekzistues. Informacioni mund të përmblihet së bashku me një nga lëndët e tjera, ndofta, “Teknologjitë e Avancuara në Multimedia” për të dhënë ato njohuri matematikore që i nevojiten studentëve në një Master profesional.



56






2. Diversifikimi i kontakteve me mediat për të krijuar më shumë mundësi për punësim për studentët që përfundojnë këtë program studimi.
3. Departamenti duhet të angazohet për të kryer gradualisht përkthimin në shqip të një pjese të literaturës që rekomandohet në lëndët që zhvillohen në këtë program studimi.
4. UAMD dhe Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit duhet të krijojë një rrjet të qëndrueshëm me institucione dhe subjekte publike e private, të përshtatshme për studentët të kryejnë praktikat profesionale.
5. UAMD dhe Fakulteti i Teknologjisë duhet të sigurojë vijueshmërinë e qëndrueshme të zhvillimit të programit të ciklit të dytë Master Profesional “Multimedia dhe Televizioni Dixhital” edhe pas përfundimit të projektit. UAMD duhet të bëjë më shumë promovim dhe informim për këtë program edhe në degët e tjera të fakultetit, në mediat tradicionale dhe/apo në rrjetet sociale për përparësitë dhe mundësitë që ofron ky program studimi.
6. Të ndërhyhet që sistemi i kompjuterëve në Bibliotekën e godinës A të UAMD-së të jetë në gjendje pune, në shërbim të studentëve dhe trupës akademike që frekuenton këto mjedise.
7. Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit dhe Departamenti që menaxhon programin Master Profesional në “Multimedia dhe Televizioni Dixhital” duhet mundësojë, që duke filluar nga ky vit akademik (2019-2020), studentët me rezultate të mira (sipas një kriteri të vendosur nga UAMD, p.sh. note mesatare mbi 8) të përfshihen në procesin e realizimit të punimeve të diplomave.
8. Anëtarëve të stafit akademik, të angazhuar në këtë program studimi, duhet t’ju lehtësohen procedurat burokratike për mbështetjen e pjesëmarrjes së tyre në aktivitete ndërkombëtare me karakter kërkimor dhe shkencor në fushën që ata kontribuojnë në Masterin Profesional “Multimedia dhe Televizioni Dixhital”.



57



**Conclusions on the evaluation of the Professional Master “Multimedia and Digital Television” with profiles Production and Postproduction; 3D Animation; Image processing; of Higher Education Institute “Universiteti Aleksandër Moisiu, Durrës”**

**Strengths and affirmations**

1. The Professional Master Program “Multimedia and Digital Television” was established thanks to the cooperation and funding under the EU project “Development and Implementation of Multimedia and Digital TV Curricula (DIMTV)” program “Erasmus +”.
2. Collaborate with international institutions and foreign universities to build the program, gaining experience in the field of study where the program is focused.
3. There is the possibility that UAMD students of Bachelor program of digital TV, to follow up the Master program.
4. Very good cooperation between academic staff and students
5. The multimedia lab and computer center are well equipped, meeting the needs for Category B and C courses.
6. Collaboration with other UAMD departments and faculty to reflect on media activities taking place at the University.

**Weak points**

1. Lack of academic staff with degrees in the specific field of multimedia and digital technology in the country.
2. Not fully (not all chapters) compatible of the Mathematics course program with the study profile of a Professional Master in Multimedia and Digital Television.
3. The literature recommended in the courses in this study program is in English only.
4. Lack of a sustainable network with appropriate and effective public and private institutions and entities to engage students in this study program in professional practice

**Recommendations**

1. The GVJ opinion is that the Course Outline of “Mathematics for Multimedia” should have less teaching hours and less credits in this study program. This is Category A course. The profile of this study Professional Master Program does not need such detailed information and topics explained as they are available under the existing syllabus. The information can be summarized along with one of the other courses, perhaps, "Advanced Technologies in Multimedia" to provide the mathematical knowledge students need in a Professional Master Program.

2. Diversifying media contacts to create and further strengthened opportunities for students' employment after completing this study program.
3. The Department should commit itself to gradually translate into Albanian parts of the literature recommended in the subjects under this study program.
4. UAMD and the Faculty of Information Technology should establish a stable network of public and private institutions and entities for students to undergo their professional internships.
5. UAMD and the Faculty of Technology should established a sustainable development of the second cycle Master Professional Multimedia and Digital Television program even after the completion of the Erasmus project. UAMD need to further and strongly promote this study program to other faculties. This promotion could be done through traditional media and/or social media pointing out the advantages and opportunities of this study program.
6. Intervene that the computer system at the Library of the A Building at UAMD is functional, serving to the students and the academic staff who attend these facilities.
7. The Faculty of Information Technology and the Department managing the Professional Master's program in "Multimedia and Digital Television" need to take action that by this academic year (2019-2020), students with good results (according to a criterion set by UAMD, let say average score results above 8) complete their diploma with working project rather than theoretical exams.
8. Academic staff members engaged in this study program should be facilitated by bureaucratic procedures for their support in participating in international research and scientific activities in the field that they contribute to this Professional Master Program.

### Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

60